

# KONCEPT DOKUMENT HARTËZIMI I SISTEMIT TË KËRKIMIT DHE INOVACIONIT NË KOSOVË



---

**Ky dokument është hartuar me ndihmën  
e ekspertëve nacional të HERAS:**

**Hamit Qeriqi  
dhe  
Bujar Gallopeni**

---

---

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	5
2. METODOLOGJIA .....	6
3. ANALIZA E SITUATËS .....	7
3.1. Korniza institucionale për K&I .....	7
3.2. Korniza ligjore për K&I .....	11
3.3. Korniza strategjike kombëtare për K&I .....	13
3.4. Prioritetet kombëtare në fushën e kërkimit shkencor .....	16
3.5. Financimi i K&I .....	17
3.6. Projektet e donatorëve .....	18
4. PROGRAMET DHE INICIATIVAT NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE .....	19
4.1. Zona Evropiane e Kërkimit (ERA) .....	19
4.2. Programet e tjera ndërkombëtare me rëndësi për sistemin kombëtar të K&I .....	20
5. GJENDJA AKTUALE E K&I NË KOSOVË .....	24
5.1. Efikasiteti i institucioneve të K&I .....	24
5.2. Zbatimi i politikave të K&I .....	24
5.3. Fondet dhe shpenzimet për K&I .....	27
5.4. Kapacitetet kërkimore dhe publikimet .....	31
5.5. Infrastrukturat kërkimore-shkencore .....	34
6. PËRVOJA E VENDEVE RAJONALE .....	39
6.1. Sistemi austriak i K&I .....	39
6.2. Sistemi i K&I i Malit të Zi .....	42
7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	48
7.1. Komente përmbyllëse .....	48
7.2. Rekomandime .....	51
REFERENCAT .....	53
SHTOJCAT .....	55
Shtojca 1: Rolet dhe përgjegjësitë në fushën e K&I .....	55
Shtojca 2: Projektet e donatorëve .....	57
Shtojca 3: Prioritetet dhe treguesit e ERA-s, dhe vlerësimi i statusit fillestar të Kosovës .....	58
Shtojca 4: Buxheti i institucioneve të K&I .....	63

---

## Shkurtesat

<b>UA</b>	Udhëzim administrativ
<b>AL</b>	Arsimi i Lartë
<b>AL</b>	Arsimi i Lartë
<b>ALShT</b>	Arsimi i Lartë, Shkenca dhe Teknologjia
<b>ASHAK</b>	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BNShAL</b>	Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Shkencë dhe Arsimin e Lartë
<b>CEEPUS</b>	Programi i Evropës Qendrore për shkëmbime në studimet universitare
<b>COST</b>	Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji
<b>EHEA</b>	Zona Evropiane e Arsimit të Lartë
<b>ERA</b>	Zona Evropiane e Kërkimit
<b>FIK</b>	Fondi i Inovacionit të Kërkimit
<b>FKSh</b>	Fondi Kombëtar për Shkencë
<b>IAL</b>	Institucionet e arsimit të lartë
<b>IShTDT</b>	Inovacioni shkencor dhe transferi i dijes dhe teknologjisë
<b>ITT</b>	Inovacioni dhe teknologjia e transferit
<b>K&amp;I</b>	Kërkimi dhe Inovacioni
<b>KBR</b>	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
<b>KISh</b>	Këshilli i Inovacionit Shkencor
<b>KKSh</b>	Këshilli Kombëtar i Shkencës
<b>KKSh</b>	Këshilli Kombëtar i Shkencës
<b>LVKSh</b>	Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MIN</b>	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
<b>OBEZH</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PBB</b>	Prodhimi i Brendshëm Bruto
<b>PKSh</b>	Programi Kombëtar i Shkencës
<b>PRE</b>	Programi për Reforma në Ekonomi
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>SKZh</b>	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
<b>ShT</b>	Shkenca dhe Teknologjia
<b>TIK</b>	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
<b>VKSh</b>	Veprimtaria kërkimore-shkencore
<b>VPBN</b>	Vend Partner i Bashkëpunimit Ndërkombëtar (në Horizon 2020)
<b>WISE</b>	Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për K&Zh për Inovacion
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>ZPS</b>	Zyra e Planifikimit Strategjik
<b>ZhKI</b>	Zhvillimi i Kërkimit dhe Inovacioni

## 1. HYRJE

Përgatitja e këtij dokumenti të konceptit është bërë në kuadër të Projektit Arsimi i Lartë, Kërkimi dhe Shkencat e Aplikuara (HEARS). Ai paraqet një pasqyrë të fushës së Kërkimit dhe Inovacionit (K&I) duke i paraqitur sfidat e situatës aktuale në Kosovë në aspekt të institucioneve të përfshira në fushën e K&I, legjislacionit kombëtar, strategjive të miratuara kombëtare, programeve, dhe buxhetit, që merren me fushat e K&I.

Ai identifikon dhe ofron një hartë gjithëpërfshirëse të të gjitha institucioneve të rëndësishme për hartimin e politikave dhe zbatimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe strategjike, si dhe pjesëmarrjen në programe të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, që lidhen me K&I. Më tej, ky dokument koncepti i analizon rezultatet e arritura deri më tani në zbatimin e politikave publike dhe thithjen e fondeve ekzistuese kushtuar K&I në Kosovë dhe pjesëmarrjen e Kosovës në programet rajonale dhe ndërkombëtare të dedikuara për aktivitetet e K&I.

Ky dokument koncepti ofron një krahasim të përgjithshëm të sistemit të K&I të Kosovës me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA), një krahasim midis sistemit të K&I në Kosovë dhe Mal të Zi në bazë të një numri të kriterëve të përcaktuara.

Në fund, në bazë të analizës dhe të gjetjeve, ky dokument koncepti jep përfundime të hollësishme dhe një numër rekomandimesh për MASHT-in dhe palët e tjera të interesuara në mënyrë që të punojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të K&I në Kosovë dhe për përgatitjen për përfshirjen e saj në Zonën Evropiane të Kërkimit.

## 2. METODOLOGJIA

Ky dokument koncepti është përgatitur në bazë të qasjes së kërkimit cilësor duke përdorur burime dytësore (kërkim në zyrë) dhe burime parësore (intervista). Fillimisht, kërkimi në zyrë u krye duke e analizuar kornizën ekzistuese ligjore, dokumentet e politikave, studimet dhe raportet në lidhje me arsimin, kërkimin shkencor, shkencën dhe inovacionin, infrastrukturën kërkimore, shpenzimet dhe buxhetin e alokuar për aktivitete kërkimore, programet dhe fondet ndërkombëtare, etj. Të gjitha dokumentet e zgjedhura për qëllimet e kërkimit në zyrë janë burime të publikuara, në të cilat ka qasje publiku i gjerë. Pas grumbullimit të të gjitha informatave relevante u bë analiza e përmbajtjes.

Përveç kërkimit në zyrë, u realizuan një numër intervistash gjysmë të strukturuar me punonjësit përkatës, që janë përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e politikave të kërkimit shkencor, të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë (ALShT) në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Një numër pyetjesh u janë bërë të gjithë punonjësve të përzgjedhur të MASHT-it, për t'i konstatuar pikëpamjet e tyre për çështjet kryesore, si dhe një grup pyetjesh që kishin të bëjnë posaçërisht me rolin dhe pozicionin e secilit prej divizioneve. Në fund, analiza e përmbajtjes u ndërlidh me gjetjet nga intervistat gjysmë të strukturuar, dhe u vërtetua informacioni nga kërkimi në zyrë gjatë intervistave gjysmë të strukturuar.

Përgatitja e këtij dokumenti u bë duke përdorur qasje bashkëpunuese. Ekipi i HEARS-it organizoi tre takime pune dhe një prezantim, ku përfaqësuesit nga Departamenti i ALSHT-së dhe ekspertët e angazhuar punuan në finalizimin e skicës së dokumenteve të konceptit dhe prezantimin e përparimit të arritur drejt hartimit të këtij dokumenti.

### 3. ANALIZA E SITUATËS

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes së sistemit të kërkimit, shkencës dhe inovacionit (K&I). Sistemi i K&I i Kosovës është ende i pazhvilluar dhe është njëri nga më pak të zhvilluarit në rajon. Ai kishte rezultat të dobët në të katër dimensionet e politikave: udhëheqjen e politikave të ZhKI; bazën kërkimore; veprimtarinë e ZhKI të sektorit privat; dhe bashkëpunimin e universiteteve me biznesin, dhe për këtë arsye Kosova u rendit e dyta nga fundi nga Pasqyra e Konkurrencës (Competitiveness Outlook) së Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH)<sup>1</sup>.

Zona e K&I ishte lënë pas dore për shumë vite dhe "vetëm kohët e fundit ajo është njohur si parakusht, e jo si pasojë e zhvillimit të brendshëm ekonomik"<sup>2</sup>. Përpjekjet e para për t'i mbështetur aktivitetet kërkimore me politika filluan në vitin 2010 me miratimin e Programit Kombëtar të Shkencës 2010-2015 (PKSh).

Kosova është ende në proces të miratimit të kornizave relevante, në vend të avancimit të zbatimit të tyre. Kosova ka bërë një hap përpara me miratimin e kornizës së re ligjore që e rregullon sektorin e K&I. Është arritur përparim i kufizuar në fushën e inovacionit<sup>3</sup>.

Zbatimi i dokumenteve ligjore dhe strategjike, "ka qenë i ngadaltë dhe agjencia përgjegjëse shpesh ka dështuar t'i shpenzojë plotësisht mjetet modeste buxhetore që i janë alokuar"<sup>4</sup>.

Në seksionin vijues shpjegohet situata e sistemit të K&I në Kosovë, korniza ligjore dhe strategjike, vendosja institucionale dhe udhëheqja në fushën e K&I, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të K&I.

#### 3.1. Korniza institucionale për K&I

K&I është një zonë mjaft e gjerë dhe një varg aktorësh dhe organesh institucionale janë të përfshirë në udhëheqjen dhe zbatimin e K&I në nivel kombëtar. Kjo përfshin institucionet për zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe të politikave, si dhe realizuesit e veprimtarisë kërkimore dhe të inovacionit

Në seksionin vijues janë dhënë informacione të shkurtra rreth institucioneve të përfshira në kërkimin shkencor dhe inovacionin shkencor.

**Kuvendi i Kosovës** e miraton legjislacionin për K&I, si dhe i miraton dokumentet e politikave dhe ato financiare, siç është Programi Kombëtar i Shkencës dhe Fondi Kombëtar për Shkencë. Ai gjithashtu i emëron organet për K&I, siç është Këshilli Kombëtar i Shkencës.

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)** është përgjegjëse për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe sistemin e arsimit të lartë dhe promovimin e zhvillimit teknologjik. Ajo është përgjegjëse për miratimin e politikës publike në fushën e kërkimit dhe sistemeve arsimore. Për më tepër, MASHT-i është përgjegjës për financimin e programeve të saj të zhvillimit dhe të politikave. Në fushën e kërkimit shkencor, MASHT-i ka për detyrë të ndajë fonde për kërkim, si dhe t'i zbatojë instrumentet e tij financiarë për zbatimin e PKSh-së<sup>5</sup>. Ndërsa sa i përket inovacionit shkencor, sipas Ligjit për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë (IShTDT), MASHT-i është institucioni kryesor përgjegjës për

<sup>1</sup> Konkurrenca në Evropën Juglindore. Pasqyrë e politikave 2018, OBEZH, 2018.

<sup>2</sup> Praktikat më të mira të bashkëpunimit biznes-universitete-qeveri për inovacionin në Kosovë, OBEZH, 2016.

<sup>3</sup> Raporti i përparimit i BE-së për vitin 2019

<sup>4</sup> Praktikat më të mira të bashkëpunimit biznes-universitete-qeveri për inovacionin në Kosovë, OBEZH, 2016.

<sup>5</sup> Ligji për Veprimtarinë Shkencore, Nr. 04/L-135

përgatitjen e politikave të inovacionit dhe zbatimin e mekanizmave për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë. Sipas rregullores aktuale për organizimin e brendshëm të MASHT-it, Departamenti i Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë (DALShT) është organi kryesor përgjegjës në fushën e Arsimit të Lartë, Kërkimit dhe Teknologjisë. DALShT-i përbëhet nga pesë divizione, nga të cilat tre ndajnë përgjegjësi në fushën e K&I:

- Divizioni i Shkencës dhe Teknologjisë (ShT)
- Divizioni i Inovacionit dhe Transferit të Teknologjisë (ITT)
- Divizioni i Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Shkencë dhe Arsimin e Lartë (BNShAL)<sup>6</sup>.

**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN).** Për t'i forcuar politikat e inovacionit dhe zhvillimin e tij, Qeveria e Kosovës (QK) themeloi Ministrinë e re për Inovacion dhe Ndërmarrësi në vitin 2017 dhe u dha përparësi reformave në inovacion, kërkim dhe arsimin e lartë. MIN është përgjegjëse për hartimin, zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. MIN është e përqendruar në promovimin e inovacionit dhe krijimin e mekanizmave të koordinimit institucional midis shkencës, sektorit privat dhe politikë-bërjes<sup>7</sup>. Departamenti i Inovacionit në kuadër të MIN-it ka një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e inovacionit.

**Këshilli Kombëtar i Shkencës (KKSh)** - sipas Ligjit mbi Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (VKSh), ka për detyrë ta mbështesë "zhvillimin sistematik të veprimtarisë shkencore-kërkimore dhe teknologjike në Republikën e Kosovës"<sup>8</sup>. Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të KKSh-së është e rregulluar me Ligjin për VKSh. Ai përbëhet nga 15 anëtarë dhe është përgjegjës "për zhvillimin e Programit Kombëtar të Shkencës (PKSh), vlerësimin në mënyrë krahasuese të situatës në lidhje me veprimtarinë shkencore-kërkimore, pozitën dhe zhvillimin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe propozimin dhe inkurajimin e masave që kanë për qëllim avancimin e veprimtarisë shkencore-kërkimore"<sup>9</sup>. Megjithatë, KKSh nuk është rifunksionizuar nga Qeveria që nga 2011.

**Këshilli i Inovacionit Shkencor (KISh)** - duhet të themelohet sipas Ligjit për ISHTDT. MASHT-i, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, e themelon KISh-in për ta monitoruar zhvillimin dhe zbatimin komercial të inovacioneve shkencore. Aktiviteti i KISh-it administrohet dhe koordinohet nga Departamenti i ALSHT-së së MASHT-it. Hapi i parë drejt funksionalizimit të KISh-it ka filluar me përgatitjen e draftit të Udhëzimit Administrativ (UA) për organizimin, veprimtarinë dhe përbërjen e këshillit për inovacion shkencor, transferin e dijes dhe teknologjisë. Ai nuk është miratuar ende nga MASHT-i, megjithatë ky UA në të ardhmen do ta rregullojë përbërjen, organizimin dhe veprimtarinë e KISh-it. Sipas Ligjit për ISHTDT, KISh-i duhet të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë me rezultate të dëshmuara ndërkombëtare në shkencë, inovacion shkencor dhe biznes.

Ligji për VKSh e përkufizon organizatën kërkimore si njësi ekonomike, si universitet ose institut kërkimor, pavarësisht nga statusi ligjor i tyre, qëllimi kryesor i të cilit është të kryejë kërkime themelore, kërkime industriale apo zhvillim eksperimental për t'i shpërndarë rezultatet e tyre me ndihmën e mësimdhënies ose publikimeve. Ai gjithashtu i përkufizon bartësit e veprimtarisë kërkimore-shkencore, siç janë institucionet shkencore dhe punëtorët shkencorë

<sup>6</sup> Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

<sup>7</sup> Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

<sup>8</sup> Ligji për veprimtari kërkimore-shkencore

<sup>9</sup> Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë. KEEN, 2018.



dhe hulumtuesit që kanë tituj përkatës shkencorë dhe hulumtues apo arsimim përkatës akademik.

Sipas Ligjit për VKSh, institucionet e vetme që janë renditur në mënyrë të qartë si subjekte kërkimore-shkencore publike janë:

- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
- Universitetet
- Instituti Albanologjik i Prishtinës
- Instituti i Historisë
- Institucione të tjera shkencore-kërkimore dhe të arsimit të lartë

MASHT-i është përgjegjës për licencimin e institucioneve shkencore. KKSh-ja është ngarkuar të ofrojë mendim për sa i përket përmbushjes së standardeve për organizimin dhe zhvillimin e organizatave kërkimore-shkencore, ndërsa MASHT-i e ka kompetencën për ta dhënë licencën (pas mendimit pozitiv) dhe ta regjistrojë organizatën shkencore private në Regjistrin e Instituteve Kërkimore-Shkencore.

Meqenëse procesi i regjistrimit dhe licencimit ende nuk është realizuar, MASHT-i nuk ka informacion për numrin e institucioneve kërkimore që janë aktive në Kosovë. Për qëllimin e këtij raporti, duke përdorur burime të ndryshme (raporte, ueb-faqe) janë identifikuar një numër institucionesh me komponente të kërkimit shkencor (kërkimi shkencor jo si aktivitet kryesor<sup>10</sup>) si më poshtë:

- Instituti Pedagogjik i Kosovës (<https://ipkmasht.rks-gov.net/?lang=en>)
- Instituti i Leposaviqit
- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (<http://niph-rks.org/?lang=en>)
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (<https://www.ammk-rks.net/?page=1,90>)
- Instituti i Planifikimit Hapësinor (<https://www.ammk-rks.net/?page=1,91>)
- Instituti Bujqësor i Kosovës (<https://www.mbpzhr-ks.net/en/kosovo-agriculture-institute>)
- Qendra për Energji dhe Resurse Natyrore (<https://www.rit.edu/research/cenr/aboutus>)
- Qendra e Inovacionit të Kosovës (QIK) (<https://ickosovo.com/about>)

Sipas Ligjit për IShTDT, institucionet publike ose private që merren me veprimtari të inovacionit shkencor janë:

- Institucionet zhvillimore prodhuese
- Institucionet hulumtuese kërkimore
- Institucionet e inovacionit shkencor

Për më tepër, Ligji për IShTDT përkufizon se cilat janë institucionet mbështetëse për ofrimin e ndihmës infrastrukturore në fushën e inovacionit shkencor: Inkubatori afarist-teknologjik; parku shkencor-teknologjik; dhe akseleratorët (përshejtuesit) e inovacionit shkencor.

### **Hartëzimi i rolit dhe kompetencave të institucioneve të K&I**

Literatura e politikave publike ka mjaft referenca në hartëzimet ose analizat institucionale dhe të palëve të interesuara. Pala e interesuar përkufizohet si persona, grup ose organizatë, interesat dhe aktivitetet e të cilëve ndikojnë fuqishëm dhe ndikohen nga çështjet në fjalë, të cilët kanë interes për ndryshim, të cilët kontrollojnë informata dhe burime relevante dhe mbështetja e të cilëve është e nevojshme për ta zbatuar ndryshimin (Morgan dhe Taschereau, 1996). Analiza e palëve të interesuara i identifikon palët e interesuara dhe e harton fuqinë, ndikimin dhe interesat e tyre relative në një fushë të caktuar ose në lidhje me një iniciativë specifike, e identifikon rolin dhe arenën e veprimit të secilës palë të interesuar.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion; Seria e dokumenteve të vendit - Kosova. Projekti i Asistencës Teknike i Bankës Botërore i financuar nga Komisioni Evropian, 2013.

<sup>11</sup> Paul Aligica. "Hartëzimi institucional dhe i palëve të interesit: Korniza për Analizën e Politikave dhe Ndryshimin Institucional," Public Organization Review, 2006.

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur organizimi i sistemit kombëtar të K&I:




Figura 1. Organizimi i sistemit kombëtar për K&I.

Hartëzimi i rolit dhe i përgjegjësive të institucioneve për K&I në Kosovë u përqendrua në kuptimin e shpërndarjes ekzistuese të kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve, si dhe në ndërveprimet e tyre në procesin e hartimit të politikave dhe zbatimin e politikave publike, që janë relevante për fushën e K&I. Në tabelën në Shtojcën 1 është paraqitur hartëzimi i roleve dhe i përgjegjësive në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit.

## 3.2. Korniza ligjore për K&I

MASHT-i është institucioni rregullator që e rregullon infrastrukturën legislative për veprimtarinë kërkimore. Ligjet kryesore që e rregullojnë sistemin e K&I janë dhënë më poshtë:

- Ligji (Nr. 04/L-135) për Veprimtari Kërkimore-Shkencore
- Ligji (Nr. 06/L-049) për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë
- Ligji (Nr.04/L-037) për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës
- Ligji (Nr. 2004/19) për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

**Ligji për VKSh**, synon të ofrojë mbështetje që rezultatet dhe veprimtaria e kërkimit shkencor t'i ndjekin kërkesat e teknologjisë së re dhe se kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë dhe të ekonomisë në Kosovë. Ky ligj e rregullon themelimin e institucioneve të kërkimit shkencor dhe procedurat e licencimit të tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe studiuesve, si dhe e përcakton rolin e VKSh-së. Pastaj e përkufizon krijimin e Këshillave Shkencorë në fushat përkatëse, dhe mënyrën e financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë.

Ligji për VKSh i përcakton dispozitat për PKSh-në, miratimin dhe zbatimin e tij, si dhe ndarjen e fondeve dhe mekanizmat për zbatimin e PKSh-së. Për më tepër, ligji për VKSh e përcakton PKSh-në si një udhërrëfyes të politikave për kërkim, që do të mundësojë zhvillimin e fushave shkencore dhe të kapaciteteve shkencore institucionale

Pastaj përkufizon se veprimtaria shkencore-kërkimore, transferi i dijes dhe i teknologjisë dhe inovacioni përfshijnë: (1) kërkimet shkencore-zhvillimore dhe publikimin e rezultateve të tyre; (2) aftësimin e kuadrove për punë kërkimore shkencore dhe zhvillimore; (3) transferin e dijes dhe teknologjisë; (4) njohjen dhe promovimin e inovacionit që del si rezultat i kërkimeve shkencore; (5) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore-shkencore që i ndihmon përparimit ekonomik, teknologjik, kulturor dhe social të vendit<sup>12</sup>.

Sa i përket bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor, neni 12 i Ligjit për VKSh, thekson se "institutet kërkimore-shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë bashkëpunojnë me qëllim të ndërlidhjes dhe shfrytëzimit të përvojave të punës kërkimore-shkencore dhe arsimore dhe të shfrytëzimit të përvojave të njëri tjetrit për kërkime multidisiplinare".

Sa i përket financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, Ligji për VKSh kërkon që 0.7 përqind e buxhetit të qeverisë të ndahet për kërkime shkencore në mënyrë që të realizohen dhe të zhvillohen kërkime shkencore.

---

<sup>12</sup> Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

**Zbatimi i Ligjit për VKSh.** MASHT-i ka lëshuar një numër Udhëzimesh Administrative (UA) për ta rregulluar procesin e financimit të projekteve dhe publikimeve shkencore:

- UA nr.26/2016 për aplikim në projektet e vogla shkencore
- UA nr.28/2016 për grantet e shkëmbimit afatshkurtër dhe për pjesëmarrje në Konferenca shkencore dhe Ndërkombëtare
- UA nr.27/2016 për Mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT-i për botime dhe publikime shkencore
- UA nr.22/2014 për Veprimtarinë e institucioneve kërkimore-shkencore në gjendje të jashtëzakonshme

Pasi u miratua Ligji i ri për VKSh në vitin 2013, MASHT-i nuk miratoi një UA të ri që do ta rregullonte procedurën për themelimin, mandatin, organizimin, zgjedhjen e anëtarëve dhe veprimtarinë e KKS-së dhe të Këshillave të fushave shkencore. Ligji për VKSh (neni 48) përcakton më tej se Agjencia Shtetërore për Kërkime Shkencore do të themelohet me ligj të veçantë.

**Ligji për inovacionin shkencor dhe transferin e dijes dhe teknologjisë (IShTDT)** - e rregullon inovacionin dhe transferimin e dijes dhe teknologjisë. Ai e përkufizon sistemin kombëtar të inovacionit shkencor si një sërë organizatash, institucioneve dhe marrëdhëniesh të tyre që kanë për qëllim gjenerimin, përhapjen dhe zbatimin e veprimtarisë shkencore dhe kërkimore dhe përmirësimeve teknologjike. Në përputhje me këtë ligj, bartësit e inovacioneve në Kosovë janë shënuar në Shtojcën 1.

Në aspekt të financimit të veprimtarisë dhe projekteve që lidhen me inovacionin shkencor dhe transferin e dijes dhe teknologjisë, ligji i përcakton burimet e mundshme të financimit, siç janë: Buxheti i Republikës së Kosovës; donacionet; fondi investues i inovacionit shkencor; investitorët engjuj dhe shoqatat e investitorëve engjuj; mekanizmat për kapital sipërmarrës (venture capital); institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat që merren me inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë; programet e Bashkimit Evropian dhe burimet e tjera<sup>13</sup>.

Sipas Ligjit për IShTDT, MASHT-i dhe ministritë e linjës kanë kompetencë ta themelojnë KISH-in me mandat për ta monitoruar zhvillimin dhe zbatimin komercial të inovacioneve shkencore.

***Zbatimi i Ligjit për IShTDT.*** MASHT-i është në proces të hartimit të akteve nënligjore që do të sigurojnë një instrument financimi për t'i mbështetur veprimet e inovacionit në Kosovë përmes skemave të kuponëve (vauçerëve) dhe për ta rregulluar përbërjen, organizimin dhe veprimtarinë e KISH-it:

- (Draft) Rregullorja për përkufizimin dhe administrimin e skemave të kuponëve (vauçerëve) të inovacionit
- Udhëzimi Administrativ për organizimin, veprimtarinë dhe përbërjen e Këshillit të Inovacionit Shkencor, transferit të dijes dhe teknologjisë.

**Ligji për Arsimin e Lartë (AL)** - i rregullon parimet e themelimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe i përshkruan rolet e tyre parësore. Në përputhje me Ligjin për AL, midis një numri objektivash të AL, një nga objektivat e arsimit të lartë është *krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore*; Për

<sup>13</sup> Ligji për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë

më tepër, ai thotë se “universiteti do të jetë një institucion i arsimit dhe i kërkimit shkencor, që jep diploma dhe grada, duke përfshirë nivelin e doktoratës. Ligji për AL kërkon që bartësit e arsimit të lartë të ndërmarrin masa dhe aktivitete kërkimore si pjesë e punës së tyre. Për më tepër, Ligji për AL dhe aktet nënligjore të tij përcaktojnë lloje të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë, megjithatë nuk e përkufizon qartë profilin e tyre për zhvillimit e kërkimit.

Për më tepër, Ligji për AL përcakton udhëzime për zhvillimin strategjik të universiteteve dhe alokimet financiare për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore midis universiteteve. Ai gjithashtu përmban dispozita për promovimin e stafit akademik, në bazë të punës së tyre kërkimore dhe publikimeve të tyre shkencore.

### 3.3. Korniza strategjike kombëtare për K&I

K&I ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik, duke u mundësuar kështu studiuesve dhe shkencëtarëve t’i zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për zhvillimin e shoqërisë. Orientimi strategjik i K&I në Kosovë është dizajnuar kryesisht duke u bazuar në PKSh-në dhe Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës. Këto dy dokumente i përshkruajnë objektivat kryesore të politikave dhe veprimet për secilin objektiv përkatës. Objektivat e përbashkëta në të dyja strategjitë janë: infrastruktura kërkimore duke përfshirë ndërtimin e laboratorëve të rinj dhe prokurimin e pajisjeve moderne; kapaciteti njerëzor duke përfshirë hulumtuesit profesionalë dhe të kaulifikuar profesionalë; ndërkombëtarizimi duke përfshirë bashkëpunimin me institucionet në mbarë botën dhe botimet në revista të njohura ndërkombëtare shkencore; dhe lidhja midis shkencës dhe zhvillimit socio-ekonomik duke përfshirë gjenerimin e studimeve që e plotësojnë dinamizmin socio-ekonomik në Kosovë. Për më tepër, fusha e K&I po ashtu është përfshirë në dokumente të ndryshme strategjike të QK-së, siç janë Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Agjenda e Reformës Evropiane, Programi për Reforma në Ekonomi, Programi i Qeverisë, etj.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016 - 2021.** SKZH-ja është dokumenti i nivelit më të lartë politik i Qeverisë së Kosovës. SKZH-ja synon t’i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës<sup>14</sup> dhe të sigurojë një agjendë të përgjithshme të zhvillimit drejt integritimit evropian, duke i identifikuar prioritetet kryesore të vendit. SKZH-ja bazohet në katër shtylla tematike:

- Shtylla 1: Zhvillimi i kapitalit njerëzor,
- Shtylla 2: Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë,
- Shtylla 3: Zhvillimi i industrive konkurruese dhe
- Shtylla 4: Zhvillimi i infrastrukturës.

Në kuadër të Shtyllës 1, *Zhvillimi i kapitalit njerëzor*, është trajtuar fusha e arsimit. Kjo shtyllë adreson lidhjen midis arsimit dhe tregut të punës. Më tej propozon aktivitete konkrete dhe masa të tilla si: "Ndërlidhja e punës hulumtuese në universitete me industrinë përmes qasjes së specializimeve të

mençura në përputhje me strategjinë Evropa 2020. Kjo nënkupton investime publike dhe private për kërkim dhe zhvillim të një numri të caktuar sektorësh industrial"<sup>15</sup>.

<sup>14</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2021 - 2016, ZKM, 2016.

SKZH-ja në Shtyllën 3, *Zhvillimi i industrive konkurruese*, thekson se ndërlidhja midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe institucioneve kërkimore në praktikë është e dobët. Po ashtu përmendet edhe niveli i ulët i shpenzimeve publike për kërkim dhe zhvillim (vetëm 0.1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto - PBP-së), si dhe mungesa e një infrastrukture koherente të inovacionit, gjë që e dëmton zhvillimin e NVM-ve. Duke marrë parasysh këtë pengesë, SKZH-ja propozon "krijimin e një skeme për mbështetjen e inovacionit, e cila do të siguronte stimuj (grante korrespondente) për investimet e NVM-ve në kërkime dhe kërkime shkencore".

**Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) 2019-2021-** e përcakton kornizën e përgjithshme të politikave dhe objektivave për rritjen ekonomike. Vëmendje e veçantë gjithashtu i kushtohet kërkimit dhe inovacionit për ta mbështetur rritjen afatgjatë. PRE-ja gjithashtu pranon se mbështetja për kërkime dhe inovacione në Kosovë është e ulët, me ç'rast buxheti për shkencë dhe kërkim arrin në rreth 0.1% të PBB-së. PRE-ja thekson se pengesa kryesore strukturore për kërkimin dhe inovacionin është mungesa e një kornize ligjore dhe politike për mbështetjen e zhvillimit të kërkimit. Për sa i përket politikave, nuk ka lehtësime tatimore për veprimtaritë për zhvillimin e kërkimit e as grante publike të ndara posaçërisht për ndërmarrjet për zhvillimin e kërkimit. "Dobësitë e identifikuar në PRE janë adresuar me strategjinë aktuale të inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe përpjekjet e vazhdueshme të MIN-it për hartimin e Ligjit për Ndërmarrësi dhe Inovacion"<sup>16</sup>.

**Programi i Qeverisë 2017-2021** ka parashikuar pesë objektiva që duhet të arrihen nga MASHT-i për periudhën katërvjeçare 2017 - 2021, si më poshtë:

- reformat në sistemin arsimor;
- përmirësimi i infrastrukturës ligjore;
- përshtatja e sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës;
- bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim;
- kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni

**Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021.** PSAK-u është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë për periudhën 2017-2021. PSAK-u i jep përparësi promovimit të kërkimit shkencor në objektivin e 7-të "Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit". Ky objektivi adreson një numër pengesash në lidhje me mungesën e integritet të punës kërkimore shkencore në aktivitetet e rregullta të institucioneve të arsimit të lartë, numrin e ulët të botimeve shkencore, mungesën e kapaciteteve të hulumtuesve, mungesën dhe infrastrukturën e pamjaftueshme për kërkime shkencore, etj. Për më tepër, në këtë objektivi, tre rezultatet e pritura, të përmendura më poshtë, kanë të bëjnë me zhvillimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë<sup>17</sup>.

- **Rezultati 7.4.** Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike;

<sup>15</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2021 - 2016, ZKM, 2016.

<sup>16</sup> Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi, MIN.

<sup>17</sup> Edukimi dhe kërkimi shkencor në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Vlerësim i përvojave të vendeve dhe performancës së tyre në programet e financuara nga BE-ja, 2019.

- **Rezultati 7.7.** Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik rritet për 25% në çdo vit.
- **Rezultati 7.11.** Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.<sup>18</sup>.

**Programi Kombëtar i Shkencës (PKSh)** synon të sigurojë një kornizë orientuese konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë dhe t'i identifikojë prioritetet kërkimore. PKSh-ja jep një pasqyrë të arsyeve për mungesën e kërkimit shkencor në Kosovë. Më tej, PKSh-ja e përqendron vizionin e saj në arritjen e 5 objektivave strategjikë për zhvillimin e kërkimit shkencor si më poshtë:

1. **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për aktivitete kërkimore-shkencore** - synon të zhvillojë programe të doktoratës me cilësi të lartë dhe të ofrojë mbështetje për të rinjtë për t'i përfunduar studimet e doktoratës në arsimin e lartë dhe institucionet kërkimore në të gjithë botën.
2. **Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore** - synon ta krijojë Programin Kombëtar të Infrastrukturës Kërkimore për ta kanalizuar financimin qeveritar për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme duke u bazuar në prioritetet kombëtare.
3. **Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore** - synon t'i përmirësojë projektet e përbashkëta kërkimore midis Kosovës dhe vendeve të tjera, dhe të sigurojë mbështetje për shkencëtarët kosovarë që të botojnë raporte në revista ndërkombëtare. Gjithashtu, ky objektiv synon ta zhvillojë programin "Kthimi i trurit" duke siguruar fonde për hulumtuesit kosovarë që jetojnë jashtë vendit.
4. **Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror** - synon t'i bashkojë përfaqësuesit e shkencës dhe biznesit për të krijuar një program të inovacionit që do t'i përshtatet qëllimeve të të dyja palëve.
5. **Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore** - synon t'i shpërblejë studiuesit më të shquar në Kosovë për çdo vit dhe të krijojë qendrën për përsosmëri shkencore.

Secili prej këtyre objektivave është i lidhur me masa të veçanta të politikave që duhet të zbatohen. Janë identifikuar 18 masa të politikave, me qëllim të inkurajimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Sipas Ligjit për VKSh (neni 41), hartimi i PKSh-së është përgjegjësi e KKSh-së. KKSh-ja ia paraqet PKSh-në QK-së, dhe pastaj QK-ja ia propozon Kuvendit për miratim për një periudhë pesë-vjeçare, i cili gjithashtu duhet t'i sigurojë fondet e programit. PKSh-ja dhe Plani i saj i implementimit theksojnë se MASHT-i është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve dhe masave të PKSh-së.

**Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi (SKIN) 2019-2023** është hartuar së fundmi, dhe është në përputhje me politikat e tjera ekzistuese dhe strategjitë përkatëse, ndër të tjera me PKSh-në dhe me politikat e ardhshme në fushën e specializimit të mençur. Ajo i përcakton objektivat dhe aktivitetet për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ta lidhur komunitetin shkencor me industrinë dhe ekonominë.

<sup>18</sup> Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021.

**Strategjia e Kosovës për TI** - është zhvilluar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Nxitja e inovacionit dhe aplikimit të kërkimit dhe zhvillimit është një nga nëntë shtyllat (objektivat strategjike) në të cilat bazohet strategjia. Shtylla që ka të bëjë me nxitjen e inovacionit dhe aplikimit të kërkimit dhe zhvillimit i përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- Realizimi i ngjarjeve informative në programin Horizon 2020 (TI)
- Prezantimi i kapitalizimit të licencimit të patentave dhe kostove të zhvillimit
- Prezantimi i stimulimeve tatimore për investime në inovacion dhe kërkim e zhvillim
- Themelimi i sistemit të hapur inovativ për industrinë kosovare të TI-së
- Prezantimi i programit të inovacionit dhe kërkimit e zhvillimit të TI-së
- Themelimi i Qendrave të Kompetencave për aplikimin e kërkimit dhe zhvillimit në tema strategjike të TI-së
- Themelimi i tryezave të rrumbullakëta të shitësve

**Plani Strategjik Universitar.** Në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë, universiteteve u kërkohet t'i hartojnë strategjitë e tyre të zhvillimit, me fokus në zhvillimin akademik dhe kërkimin shkencor, si dhe bashkëpunimin e tyre me industrinë. Ky zhvillim strategjik është i lidhur me planifikimin përkatës financiar, me alokime financiare, duke përfshirë punën kërkimore-shkencore. Universitetet e Kosovës (shumica e tyre) i kanë miratuar strategjitë e tyre për zhvillim strategjik, ku janë përfshirë edhe kërkimet. Përveç Universitetit të Prishtinës, universitetet e tjera nuk kanë strategji të veçantë kërkimore-shkencore. Megjithatë, në strategjitë e tyre të zhvillimit, kërkimi është kryesisht një aktivitet marginal dhe shumë i fragmentuar në aspekt të veprimeve strategjike të universitetit për ta përmirësuar komponentin hulumtues të universitetit. Kjo vërehet edhe me treguesit e pjesshëm financiarë të shënuar në dokumentet strategjike, dhe nga ajo se ato nuk lidhen mirë me procesin e buxhetimit vjetor, të cilin universitetet e bëjnë në bashkëpunim me qeverinë.

### 3.4. Prioritetet kombëtare në fushën e kërkimit shkencor

PKSh-ja ka identifikuar pesë prioritete kërkimore-shkencore që synojnë ta fokusojnë financimin dhe aktivitetet e K&I në fushat me interes kombëtar dhe në ato fusha të cilat do të kontribuonin në zhvillimin e mëtejshëm socio-ekonomik të Kosovës. Këto prioritete gjithashtu konsiderohen si orientim i Kosovës në fushën e kërkimit-shkencor në një periudhë pesë vjeçare. Prioritetet kombëtare sipas PKSh-së janë si më poshtë:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit
3. Kërkimet shkencore në mjekësi
4. Studimet shoqërore dhe ekonomike
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike

Këto pesë prioritete kërkimore-shkencore u zgjodhën në bazë të këtyre gjashtë kritereve

- Rëndësia për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit
- Numri dhe cilësia e burimeve njerëzore në vend dhe në diasporë
- Kushtet e infrastrukturës kërkimore
- Kontributi për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar të Kosovës
- Ekzistimi i potencialit për arritjen e rezultateve kërkimore dhe zbatimin e tyre brenda dhe jashtë
- Ekzistimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e caktuar.



Neni 17 i Ligji për VKSh (neni 17) përcakton se "Personat juridik kërkimorë-shkencorë që financohen nga buxheti i shtetit, duhet ta kenë planin e objektivave për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe strategjinë e zhvillimit e cila duhet t'i përfshijë, ndër të tjera, fushat e veprimtarisë shkencore sipas Programit Kombëtar të Shkencës. Për këtë qëllim, vetëm Universiteti i Prishtinës e ka përpiluar dhe miratuar "Strategjinë për veprimtari kërkimore- shkencore/artistike dhe zhvillimore". Pikat fillestare për zhvillimin e kësaj strategjie kanë qenë prioritetet për veprimtarinë kërkimore-shkencore/artistike të theksuara në Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015. Universiteti i Prishtinës "i konsideron këto si prioritetet e të veta kërkimore-shkencore dhe është i përkushtuar të sigurojë mbështetje të veçantë për njësitë akademike, grupet kërkimore-shkencore dhe individët që studiojnë në këto fusha<sup>19</sup>.

Për më tepër, strategjia kërkimore-shkencore e Universitetit të Prishtinës përqendrohet në katër fusha, të cilat gjithashtu korrespondojnë me PKSh-në. Këto fusha përfshijnë: burimet njerëzore, infrastrukturën kërkimore-shkencore, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe lidhjet me ekonominë dhe shoqërinë.

### 3.5. Financimi i K&I

Ligji për VKSh e përcakton sasinë e fondeve vjetore që duhet t'i kushtohen veprimtarisë së kërkimit shkencor. Neni 5 i Ligjit për VKSh, thekson se "Për sigurimin e kushteve dhe mjeteve të nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan zero pikë shtatë përqind (0.7%) të buxhetit vjetor vendor.<sup>20</sup>".

PBB-ja që Kosova ia ka kushtuar kërkimit shkencor dhe zhvillimit është një nga më të ulëtat në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Shpenzimet publike për kërkime shkencore dhe inovacion në vitin 2016 "arritën në vetëm" 0.05% të PBB-së, nga të cilat vetëm një e pesta ishte alokuar për kërkime shkencore dhe grante <sup>21</sup>. Shpenzimet qeveritare për kërkime shkencore në vitin 2017 ishin 0.1% të PBB-së. Kosova ka një rezultat të dobët bile edhe në shfrytëzimin e këtij buxheti, shpesh duke arritur ta shpenzojë mezi gjysmën e tij<sup>22</sup>. Kjo është pasqyrë e përkushtimit të dobët politik ndaj K&I.

Përveç financimit nga qeveria, organizata të ndryshme donatore (ndërkombëtare, bilaterale dhe shumëpalëshe) mbështesin projekte aplikative dhe zhvillimore kërkimore shkencore. Organizata të tilla si Komisioni Evropian, Banka Botërore, ADA, USAID-i, dhe organizata të tjera paraqesin burimin kryesor të shumicës së K&I në Kosovë. Aktualisht, burimet kryesore të fondeve të përmendura në Raportin e përparimit janë dy projekte afatgjata bilaterale me Austrinë (HERAS) dhe SHBA-në (TTL)<sup>23</sup>.

Nuk ka të dhëna statistikore për shpenzimet private (të biznesit) për kërkime shkencore dhe zhvillim. Madhësia e vogël e ekonomisë e zvogëlon kapacitetin për të investuar në infrastrukturën kërkimore-shkencore. Pajisjet moderne për laboratorë të avancuar kërkojnë investime të mëdha kapitale, të cilat shpesh janë përtej kapacitetit të vendeve të vogla si Kosova.

<sup>20</sup> Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

<sup>21</sup> Raporti i përparimit i BE-së për Kosovën për vitin 2016

<sup>22</sup> Raporti i përparimit i BE-së për Kosovën për vitin 2018

<sup>23</sup> Edukimi dhe kërkimi shkencor në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Vlerësim i përvojave të vendeve dhe performancës së tyre në programet e financuara nga BE-ja, 2019.

## Fondi i inovacionit

"Fondi i inovacionit" bashkëfinancohet nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) e Republikës së Kosovës dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga Qendra e Inovacionit të Kosovës (QIK). QIK promovon dhe mbështet zhvillimin e bizneseve të reja që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. QIK në bashkëpunim me projektin "Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit" të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, të porositur nga BMZ-ja dhe i bashkëfinancuar nga MIN-i, dhe me Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të sigurojë

mbështetje financiare për NVM-të përmes skemës së granteve të "Fondit të inovacionit". Qëllimi i skemës së granteve të "Fondit të inovacionit" është t'i tërheqë idetë më inovative me potenciale për eksport dhe krijim të punësimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Shuma maksimale e grantit është 50.000 euro. Cikli i parë u shpall në vitin 2018 dhe u ndanë pesë projekte. Thirrja e dytë është shpallur në vitin 2019, dhe u ndanë tetë projekte.<sup>24</sup>

### 3.6. Projektet e donatorëve

Përveç burimeve nga buxheti kombëtar që ndahen për aktivitete të K&I, ekzistojnë disa organizata dhe programe ndërkombëtare që synojnë nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të Kosovës.

- Banka Botërore është një nga mbështetësit kryesorë të sektorit të arsimit në Kosovë, duke i mbështetur strategjitë parauniversitare dhe ato të arsimit të lartë, forcimin e organizimit dhe financimit të sistemit arsimor në Kosovë. Në Tabelën 1 në Shtojcën 2 janë paraqitur projektet aktuale dhe të kaluara të mbështetura nga BB-ja në fushën e arsimit.
- BE-ja është donatori më i madh ndërkombëtar në Kosovë. Që nga viti 2007, është ofruar ndihmë përmes Instrumentit për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA), që është mjete kryesor i strategjisë për ndihmën e para-anëtarësimit të Komisionit Evropian. Në Tabelën 2 në Shtojcën 2 janë paraqitur projektet aktuale dhe të kaluara të financuara nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) - kryesisht ofron mbështetje për arsimin e lartë, duke përfshirë veprimtarinë kërkimore-shkencore. Lista e projekteve të mbështetura nga ADA është paraqitur në Tabelën 3 të Shtojcës 2.

- Donatorë të tjerë të rëndësishëm të K&I janë: USAID-i, GIZ-i, SDC-ja, etj.

Si konkluzion mund të themi se ekziston një numër i konsiderueshëm i institucioneve donatore ndërkombëtare që ofrojnë mbështetje për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë. Megjithatë, shumica e programeve të tyre kanë për qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale në sektorin e arsimit në përgjithësi dhe mbështetjen e zhvillimit të burimeve njerëzore. Kurse vetëm pak prej tyre janë të përqendruara në forcimin e aspekteve të kapaciteteve shkencore, teknologjike dhe të inovacionit. Kjo sugjeron se ka hapësirë për qeverinë që të mobilizojë fonde në mbështetje të një strategjie të ardhshme të inovacionit.

<sup>24</sup> <https://ickosovo.com/innovation-fund>

## 4. PROGRAMET DHE INICIATIVAT NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

### 4.1. Zona Evropiane e Kërkimit (ERA)

Zona Evropiane e Kërkimit është një zonë e përbashkët e interesit, ku vendet evropiane kanë masë të përbashkët të zhvillimit të kërkimit shkencor. Kjo zonë e përbashkët e kërkimit shkencor e promovon bashkëpunimin në kërkimin shkencor dhe shkëmbimin e studiuesve. Ka gjashtë prioritet kryesore të përcaktuara në ERA:

- Sisteme më efektive kombëtare të kërkimit shkencor;
- Bashkëpunimi dhe konkurrenca optimale transnacionale, duke përfshirë bashkëpunimin dhe konkurrencën optimale transnacionale dhe infrastrukturën e kërkimit shkencor;
- Tregu i hapur i punës për studiuesit;
- Barazia gjinore dhe integrimi gjinor në kërkimet shkencore;
- Qarkullimi optimal, qasja në dhe transferimi i njohurive shkencore duke përfshirë qarkullimin e njohurive dhe qasjen e hapur;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;

Për t'i avancuar sistemet kombëtare të kërkimit shkencor dhe të inovacionit, vendet punojnë në 24 tregues drejt adresimit të prioriteteve të lartpërmendura. Në Shtojcën 3 është dhënë lista e treguesve dhe pasqyra e gjendjes aktuale të Kosovës.

Për vendet që zgjedhin të integrohen në Bashkimin Evropian, një faktor i rëndësishëm për krahasimin e zhvillimit kombëtar të kërkimit shkencor dhe inovacionit është krahasimi i tij me Unionin e Inovacioneve dhe me Zonën Evropiane të Kërkimit (ERA). Ky është një proces që gjithashtu lidhet shumë me *Acquis communautaire*, kornizën kryesore të legjislacionit të BE-së, përkatësisht Kapitullin 25, Shkenca dhe Kërkimi. Edhe pse *acquis* nuk kërkon transpozimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të tij shkencore dhe hulumtuese në vendet aderuese, pritshmëritë drejt pranimit janë se vendet duhet të përafrohen në masë të madhe me kornizën e ERA-s, duke qenë në gjendje të marrin pjesë në masë të madhe dhe të suksesshme në programet kornizë të BE-së për shkencë, kërkim dhe inovacion. Prandaj, Republika e Kosovës, si një vend kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duhet ta përdorë kornizën dhe prioritetet e ERA-s për zhvillimin e sistemit kombëtar të K&I. Për të krijuar një bazë të qartë të situatës aktuale të sistemit të K&I të Kosovës në krahasim me ERA-n, duhet të bëhet një analizë e plotë krahasuese. Kjo analizë duhet të çojë në një udhërrëfyes të qartë, me veprime dhe afate kohore, si dhe me aktorë përgjegjës drejt integritit të Kosovës në ERA. Kosova tashmë është përkushtuar të punojë drejt implementimit të *acquis* në shkencë dhe kërkim duke e miratuar Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA), përkatësisht çështjet e adresuara në nenin 118 të MSA-së<sup>25</sup>.

<sup>25</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150430\\_saa.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf)

## 4.2. Programet e tjera ndërkombëtare me rëndësi për sistemin kombëtar të K&I

Programet kryesore Europiane dhe rajonale në të cilat Kosova merr pjesë, dhe pjesë e të cilave është, përfshijnë:

- Korniza Evropiane e Kërkimit për Kërkim dhe Inovacion, Horizon 2020
- Programi COST
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal/Strategjia Evropa Juglindore 2020
- Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion
- Programi Erasmus +
- CEEPUS (Programi i Evropës Qendrore për shkëmbime në studimet universitare)

### Korniza Evropiane e Kërkimit për Kërkim dhe Inovacion, “Horizon 2020”

“Horizon 2020” është programi më i madh i BE-së për financim të kërkimeve dhe inovacionit. Është instrumenti kryesor i BE-së për zbatimin e ERA-s. Kosova merr pjesë në këtë program në cilësinë e Vendit Partner të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICPC). Për herë të parë Kosova filloi të marrë pjesë në vitin 2008 në Programin e Shtatë Kornizë për Kërkime Shkencore dhe Inovacion, i njohur ndryshe si FP7. Pjesëmarrja e Kosovës në FP7 ishte shumë e ulët, me 23 aplikime (duke përfshirë 31 aplikues nga Kosova) të paraqitura nga Kosova, nga të cilat 20 aplikime (duke përfshirë 28 aplikues) i plotësuan kriteret e pranueshmërisë. Numri i propozimeve dhe i pjesëmarrësve është paraqitur në tabelën më poshtë në fushat tematike të FP7:

Propozime të paraqitura të pranueshme në FP7		
Fusha tematike e FP7	Propozime	Pjesëmarrës
Shëndeti	6	7
Shkencat Shoqërore dhe Shkencat Humane (ShShShH)	5	5
Transporti	2	2
NMP	1	3
Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)	1	3
Mjedisi	1	3
SIS (Shkenca në shoqëri)	1	2
Bashkëpunimi Ndërkombëtar (INCO)	1	1
Njerëzit	1	1
Siguria	1	1
<b>Gjithsej</b>	<b>20</b>	<b>28</b>

Tabela 1. Numri i propozimeve të paraqitura dhe i pjesëmarrësve të përfshirë sipas fushave tematike të FP7.

Burimi: DG-Research and Innovation, maj 2013.

Përqindja e suksesit të Kosovës në FP7 ishte 17,86%, nga mesatarja prej 22,9% e vendeve të ICPC. Vetëm 3 nga 20 propozime të paraqitura të pranueshme u financuan.

Projektet e pranuar në FP7			
Fusha tematike e FP7	Propozime	Pjesëmarrës	Vlera financiare (euro)
Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK)	1	3	101,576.00
Shkencat Shoqërore dhe Shkencat Humane (ShShShH)	1	1	92,400.00
Bashkëpunimi Ndërkombëtar (INCO)	1	1	92,283.34
<b>Gjithsej</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>286,259.34</b>

Tabela 2. Numri i projekteve të pranuar dhe i pjesëmarrësve të përfshirë sipas fushave tematike të FP7.

Burimi: DG-Research and Innovation, maj 2013.

Në “Horizon 2020” nga viti 2014 e në vazhdim, Kosova filloi ta rrisë numrin e aplikimeve, si dhe të projekteve të pranuar. Në tabelën më poshtë janë dhënë informata mbi numrin e aplikimeve dhe kontributin e BE-së në euro, të marra nga ueb-faqja e “Horizon 2020”<sup>26</sup>:

Gjithsej aplikime	Kontributi i kërkuar nga BE-ja (EUR)	Propozime/aplikime të pranueshme	Propozime në shqyrtim	Kontributi neto i BE-së i H2020
72	7,830,807 €	66	12	1,174,594 €

Tabela 3. Numri i aplikimeve nga Kosova dhe kontributet në euro

Në tabelën më poshtë janë dhënë informata mbi numrin e aplikuesve dhe kontributin e kërkuar nga BE-ja në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor:

Emri i vendit	Propozime të pranueshme	Propozime në shqyrtim	Kontributi i kërkuar nga BE -ja (EUR)	Aplikime
Serbia	2,214	244	773,787,674 €	2,828
Maqedonia e Veriut	517	58	144,904,555 €	626
Mali i Zi	176	22	46,162,769 €	208
Kosova	66	12	7,830,807 €	72
Bosnja dhe Hercegovina	343	46	81,046,225 €	445
Shqipëria	270	24	69,671,042 €	335

Tabela 4. Kosova kundrejt vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrja e Kosovës në “Horizon 2020” mbetet mjaft e ulët. Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht statusit të Kosovës si vend i ICPC, që nuk është rasti me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, kapacitetet e pamjaftueshme për kërkime shkencore dhe për rrjetëzimin ndërkombëtar mund të llogariten si faktor tjetër i rëndësishëm për nivelin e ulët të pjesëmarrjes.

Në tabelën më poshtë janë dhënë informata mbi propozimet e suksesshme dhe jo të suksesshme sipas Prioriteteve Tematike:

Prioriteti Tematik	Propozime të pranueshme jo të suksesshme	Propozime në shqyrtim	Përqindja e suksesit të propozimeve
Hapësira	0	1	100%
Shëndeti, ndryshimi demografik dhe mirëqenia	3	3	50%
Veprimi për klimën, mjedisi, efikasiteti i burimeve dhe lëndët e para	2	2	50%
Shoqëritë e sigurta - Mbrojtja e lirisë dhe sigurisë së Evropës dhe qytetarëve të saj	3	2	40%
Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit	4	1	20%

<sup>26</sup> <https://webgate.ec.europa.eu/dashboard/sense/app/e02e4fad-3333-421f-a12a-874ac2d9f0db/sheet/941d3afe-da24-4c2e-99eb-b7fcbd8529ce/state/analysis>

Prioriteti Tematik	Propozime të pranueshme jo të suksesshme	Propozime në shqyrtim	Përqindja e suksesit të propozimeve
Hapësira	0	1	100%
Shëndeti, ndryshimi demografik dhe mirëqenia	3	3	50%
Veprimi për klimën, mjedisi, efikasiteti i burimeve dhe lëndët e para	2	2	50%
Shoqëritë e sigurta - Mbrojtja e lirisë dhe sigurisë së Evropës dhe qytetarëve të saj	3	2	40%
Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit	4	1	20%
Veprimet Marie-Sklodowska-Curie	10	1	10%
Evropa në një botë që ndryshon - Shoqëritë inkluzive, inovative dhe reflektuese	25	2	7%
Infrastrukturat e kërkimit	2	0	0%
Shkenca me dhe për shoqërinë	2	0	0%
Siguria e ushqimit, bujqësia dhe pylltaria e qëndrueshme, kërkimet detare dhe të marinës dhe të ujërave të brendshëm dhe bio-ekonomia	1	0	0%
Energji e sigurt, e pastër dhe efikase	1	0	0%
Transport i mençur, i gjelbër dhe i integruar	1	0	0%

Tabela 5 Aplikimet e pranueshme dhe ato në shqyrtim sipas Prioriteteve Tematike  
Burimi: Horizon 2020 Dashboard<sup>27</sup>

## Asociacioni COST

Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST)<sup>28</sup> është një organizatë pan-evropiane për financim dhe kërkim, e cila i mbështet iniciativat kërkimore të rrjetit kërkimor dhe të bashkëpunimit. Që nga viti 2018 Kosova ka statusin e Vendit të Afërt Fqinj (Near Neighbouring Country) dhe ka të drejtë të marrë pjesë në veprimet e COST-it. Komuniteti shkencor në Kosovë ka treguar interes të madh për të marrë pjesë në veprimet e COST-it. Sipas të dhënave, ekzistojnë 12 veprime të COST-it në të cilat marrin pjesë studiues nga Kosova. Përveç kësaj, tre veprime të tjera të COST-it janë aktualisht në procesin e vlerësimit,

## Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal/Strategjia Evropa Juglindore 2020

Kosova është anëtare e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR), dhe e ka nënshkruar Strategjinë Evropa Juglindore 2020-2029. Nën shtyllën “Rritja e mençur” të strategjisë mbështeten veprimet e përbashkëta rajonale nën dimensionin K&I dhe Inovacionet, të cilat kërkojnë bashkëpunim rajonal në katër fusha:

- Përmirësimi i përsosmërisë dhe i produktivitetit të kërkimit;
- Lehtësimi i bashkëpunimit shkencë-industri dhe transferimi i teknologjisë;
- Promovimi i inovacionit të biznesit dhe bizneset fillestare (start-up) inovative;
- Forcimi i qeverisjes së politikave kombëtare të kërkimit dhe inovacionit;

## Programi Erasmus +

Kosova merr pjesë në programet evropiane të arsimit që nga viti 2002/30. Programet e vetme arsimore në të cilat Kosova kishte të drejtë të marrë pjesë deri në fund të vitit 2013 ishin programi TEMPUS për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, si dhe programi i shkëmbimit ERASMUS MUNDUS, i cili mbështeti shkëmbimin e stafit akademik, studiuesve dhe studentëve.

<sup>27</sup> <https://webgate.ec.europa.eu/dashboard/sense/app/93297a69-09fd-4ef5-889f-b83c4e21d33e/sheet/a879124b-bfc3-493f-93a9-34f0e7fba124/state/analysis>

<sup>28</sup> <https://www.cost.eu/>

<sup>29</sup> Strategjia Evropa Juglindore 2020: <https://rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

<sup>30</sup> <http://erasmuspluskosovo.org/>

Grafiku i mëposhtëm tregon informata themelore në lidhje me KA1: SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFIN DHE STUDENTËT për KOSOVËN 2015-2018<sup>31</sup>:

Shkëmbimet afatshkurtra për stafin dhe studentët	Pjesëmarrës			
	2018	2017	2016	2015
Shkëmbimet pranuese të planifikuara për vendet e Programit (gjegjësisht "shtetasit jo-evropianë")	517	512	462	375
Shkëmbimet dërguese të planifikuara për vendet Partnere (gjegjësisht "shtetasit evropianë")	263	260	200	195
<b>Gjithsej pjesëmarrës</b>	<b>780</b>	<b>772</b>	<b>662</b>	<b>570</b>

Tabela 6. Projektet e shkëmbimeve afatshkurtra për stafin dhe studentët të Erasmus +

Shifrat e Kosovës për bursat e akorduara për Erasmus Mundus –Programin për master të përbashkët<sup>32</sup>:

Viti	2015	2016	2017	2018
<b>Nr. i studentëve</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>3</b>

Tabela 7. Erasmus Mundus –Programi për master të përbashkët 2015-2018

Në programin aktual arsimor të BE-së, Erasmus +, Kosova e zgjeroi pjesëmarrjen në skema të tjera të reja, veçanërisht që nga viti 2017, me marrëveshjen e nënshkruar me Komisionin Evropian. Kjo marrëveshje është detyruese në aspekt financiar, me ç’rast Kosova paguan faturën vjetore prej 50,000 eurosh.

Në programin Erasmus + Kosova merr pjesë në veprimet e “Key 1” (shkëmbimet dhe programet e diplomave të përbashkëta), si dhe në veprimet “Key 2”, veçanërisht në veprimin për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë.

### CEEPUS (Programi i Evropës Qendrore për shkëmbime në studimet universitare)

Që nga viti 2008 Kosova iu bashkua Programit të Evropës Qendrore për shkëmbime në studimet universitare (CEEPUS)<sup>33</sup>. Ky program kryesisht mbështet partneritetin e bashkëpunimit midis universiteteve të Evropës Qendrore dhe Juglindore dhe rrit bashkëpunimin ndër-universitar përmes shkëmbimit të stafit akademik, studiuesve dhe studentëve. Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat për numrin e përfituesve (studentë dhe staf akademik) nga CEEPUS-i:

Periudha		Studentë	Stafi akademik	GJITHSEJ
		2008 - 2019	Që vijnë <i>Numri i studentëve/profesorëve që vijnë në Kosovë nga vendet e CEEPUS-it</i>	19
	Që shkojnë <i>studentë/profesorë nga Kosova që shkojnë në vendet e CEEPUS-it</i>	201	67	<b>268</b>
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>220</b>	<b>196</b>	<b>416</b>

Tabela 8. Numri i përfituesve nga skema e shkëmbimit të CEEPUS-it

<sup>31</sup> <http://erasmuspluskosovo.org/en/erasmus/projects/>

<sup>32</sup> <http://erasmuspluskosovo.org/en/erasmus/projects/>

<sup>33</sup> <https://www.ceepus.info/#nbb>

## 5. GJENDJA AKTUALE E K&I NË KOSOVË

Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje për t'i zhvilluar politikat dhe ligjet e saj për K&I, siç janë PKSh-ja, PSAK-u dhe Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, si dhe duke i dhënë K&I një vend të rëndësishëm në politikat e tjera qeveritare, të shpjeguara në seksionin 4.4.

Në seksionet vijuese janë paraqitur problemet kryesore që ndikojnë mbi sistemin e K&I në Kosovë.

### 5.1. Efikasiteti i institucioneve të K&I

KKSh-ja ka një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për hartimin dhe zbatimin e politikave të K&I. KKSh-ja dhe 15 anëtarët e saj u miratuan në seancën plenare të Kuvendit më 12 korrik të vitit 2007, ndërsa ajo u formua dhe organet e saj u zgjodhën më 20 dhe 22 tetor të vitit 2008<sup>34</sup>. Ajo funksionoi deri në vitin 2011. Gjatë kësaj periudhe, KKSh-ja e zhvilloi PKSh-në dhe standardet e punës shkencore. Pas përfundimit të mandatit të parë të anëtarëve të KKSh-së, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të sigurojë një konsensus për të emëruar anëtarë të rinj të KKSh-së. Deri më tani KKSh-ja nuk funksionon.

Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) duhet të jenë organet kryesore që kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore. Megjithatë, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë karakterizohet nga një marginalizim i kërkimit shkencor. Universitetet kryesisht përqendrohen në mësimdhënie dhe kanë kapacitet të kufizuar për aktivitete kërkimore. Ky përfundim vlen për të gjithë sektorin, duke përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës, i cili është institucioni më i madh që merret me kërkim shkencor në Kosovë<sup>35</sup>. Institucionet e arsimit të lartë kanë qenë një kohë të gjatë të përqendruara vetëm në mësimdhënie në vend të kërkimit shkencor, dhe atyre akoma u mungon orientimi strategjik dhe kapaciteti për veprimtari kërkimore<sup>36</sup>.

Për sa i përket inovacionit, MASHT-i në bashkëpunim me ministrinë e linjës, siç kërkohet me Ligjin për ISHTDT, ende nuk ka arritur ta themelojë KSHI-në dhe institucionet e tjera mbështetëse për inkubatorin shkencor afarist-teknologjik; parkun shkencor-teknologjik dhe akseleratorët (përshejtuesit) e inovacionit shkencor. Deri tani MASHT-i ka përgatitur vetëm një Udhëzim Administrativ për organizimin, veprimtarinë dhe përbërjen e Këshillit të Inovacionit Shkencor, Transferit të Dijes dhe Teknologjisë.

### 5.2. Zbatimi i politikave të K&I

PKSh-ja është dokumenti kryesor strategjik që e paraqet orientimin strategjik dhe konceptual për zhvillimin e kapaciteteve dhe përparësive shkencore-kërkimore. Ajo është e përqendruar në zhvillimin e faktorëve kryesorë në fushën e K&I: kapaciteteve njerëzore, infrastrukturave kërkimore, ndërkombëtarizimin e K&I kombëtar, lidhjen e shkencës me ekonominë dhe përsosmërinë në K&I.

<sup>34</sup> Programi Kombëtar i Shkencës (2010).

<sup>35</sup> Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion; Seria e dokumenteve të vendit- Kosova. Projekti i Asistencës Teknike i Bankës Botërore i financuar nga Komisioni Evropian, 2013.

<sup>36</sup> Praktikat më të mira të bashkëpunimit biznes-universitete-qeveri për inovacionin në Kosovë, OBEZH, 2016. Raporti i përparimit i BE-së për vitin 2019



PKSh-ja e parë u miratua në mars të vitit 2010 për një periudhë pesë-vjeçare<sup>37</sup>. Që nga skadimi i PKSh-së së fundit në vitin 2016, Kosova nuk ka krijuar objektiva të reja strategjike për ta mbështetur zhvillimin e veprimtarisë kërkimore. Në vitin 2016, ministri i MASHT-it, lëshoi një vendim për ta zgjatur vlefshmërinë e PKSh-së dhe planin e zbatimit të saj, deri sa të rishikohet dhe hartohet PKSh-ja e re. Arsyeja për këtë vendim ishte se "aktivitetet kërkimore-shkencore do të vazhdojnë"<sup>38</sup> deri në miratimin e PKSh-së së re.

Sa i përket zbatimit të masave dhe aktiviteteve të PKSh-së, ishte planifikuar që organi kryesor përgjegjës të jetë MASHT-i, dhe, në disa raste, Agjencia e planifikuar Shtetërore për Kërkime Shkencore, e cila pritet të themelohet me një ligj të veçantë për VKSh-në<sup>39</sup>. MASHT-i ende nuk e ka krijuar një agjenci të tillë. As MASHT-i e as KSh-ja nuk kanë të dhëna të mjaftueshme për të raportuar për mbarëvajtjen e zbatimit, për shkak të mungesës së mekanizmave të monitorimit dhe mjeteve për matjen e përparimit dhe ndikimit të PKSh-së. Nuk ka një sistem të qëndrueshëm për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të planit të zbatimit të PKSh-së, prandaj, nuk ka asnjë raport që do të ofronte informacione për arritjen e objektivave dhe rezultateve të PKSh-së. Deri më tani, burimi i vetëm i informacionit në lidhje me zbatimin e PKSh-së janë tre Raporte të vlerësimit:

- Raporti i vlerësimit i PSAK-ut 2011-2016, i përgatitur në vitin 2015 nga MASHT-i
- Raporti i vlerësimit për zbatimin e PSAK-ut 2017-2021, i përgatitur në vitin 2017 nga Rrjeti i Arsimit dhe Punësimit i Kosovës (KEEN)
- Raporti vjetor i vlerësimit për vitin 2018 i PSAK-ut 2017-2021, i përgatitur në vitin 2019 nga MASHT-i.

Raporti i parë i vlerësimit për zbatimin e PSAK-ut 2011-2016, zbulon se përqindja mesatare e zbatimit të synimeve brenda nën-programit për arsim të lartë bazohet në indeksin sasior 2.5 nga 5. Indeksi i kërkimit shkencor është vlerësuar të jetë 1 nga 5, duke treguar se "plani ka vonesa të konsiderueshme në zbatimin e synimeve dhe aktiviteteve të kërkimit shkencor"<sup>40</sup>.

Në raportin vjetor të vlerësimit për vitin 2018 të PSAK-ut 2017-2021, mund të shihen ndryshimet pozitive nga viti 2017 në vitin 2018 në arritjen e rezultateve të PSAK-ut. Në këtë raport, përparimi në arritjen e rezultateve të pritura është shprehur me nivelin e zbatimit nga 1 - nuk ka përparim deri në 5 (i arritur plotësisht). Ndryshimet më domethënëse janë vërejtur në:

- përmirësimin e mekanizmave për zhvillimin profesional të stafit akademik në IAL (nga 1.2 në 3.5)
- avancimin e infrastrukturës dhe teknologjisë për mësimdhënie, punë kërkimore dhe shkencore;
- rritjen e numrit të publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare të shkruara nga stafi akademik ku është paraparë rritje prej 25% në çdo vit (nga 1.6 në 3.2).

Ndërsa në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe programet e kërkimit shkencor dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve të IAL-ve, raporti nuk tregon ndonjë ndryshim ndërmjet viteve 2017 dhe 2018.

Nga ana tjetër, një raport tjetër "Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë", i publikuar nga projekti "KEEN" në vitin 2018, paraqet më shumë argumente sa i përket zbatimit të PKSh-së. Në të njihet përparimi drejt zbatimit të PKSh-së, por gjithashtu janë paraqitur disa pengesa dhe mungesa e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të PKSh-së.<sup>41</sup> Teksti vijues në kornizë i paraqet disa informacione të nxjerra nga ky raport:

<sup>37</sup> Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës.

<sup>38</sup> Vendimi i MASHT-it numër 49/01B, i datës 10 mars 2016.

<sup>39</sup> Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

<sup>40</sup> Raporti i Vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, MASHT.

Sipas përfaqësuesve të MASHT-it, edhe me një buxhet të vogël të ndarë për zbatimin e PKS-së, disa nga aktivitetet e planifikuara filluan fazën fillestare të zbatimit. Për shembull, në kuadër të programit janë zhvilluar disa projekte shkencore, janë rritur aktivitetet e mobilitetit të komunitetit shkencor, është siguruar qasje më e madhe në burimet elektronike si dhe është krijuar çmimi për "Shkencëtarin e vitit". Megjithatë, ekspertët e tjerë të intervistuar nuk pajtohen me këtë pohim. Ata vlerësojnë se deri më sot asnjë nga aktivitetet e planifikuara në kuadër të Programit Kombëtar të Shkencës nuk është zbatuar plotësisht. Një ekspert i arsimit të lartë vlerëson se PKS nuk është zbatuar siç duhet dhe se praktikisht nuk ishte funksional për shkak të mungesës së fondeve. Përveç kësaj, nuk kishte mekanizma monitorimi për të përcjellë progresin e shënuar dhe ndikimin e programit të zbatuar pjesërisht.

Përveç kësaj, PKS parashihte krijimin e një skemë të bursave për të financuar aktivitetet kërkimore në studimet e doktoratës dhe pasdoktoratës jashtë vendit. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që të ofronte mbështetje për hulumtuesit për të zhvilluar karrierën e tyre shkencore në fushën e tyre dhe pastaj të mund të sjellin rezultatet e tyre kërkimore në Kosovë, si një mekanizëm i sjelljes së kapaciteteve të reja (brain gain). Ky aktivitet planifikohej të financonte 20 studentë të doktoratës (14,000 EUR secili) dhe 10-15 pasdoktorata (20,000 EUR secili) që arrijnë shumën rreth 530,000 EUR në vit. Ky propozim është planifikuar para tetë viteve dhe deri më sot nuk janë ndërmarrë masa konkrete për të ofruar zhvillimin e njohurive të reja. Nëse supozohet se kjo skemë e bursave do të ishte aktive për tetë vite dhe 35 studiues do të dërgoheshin në vit në studime të doktoratës apo pasdoktoratës, deri tani, Kosova do të dërgonte 280 studiues jashtë vendit. Mesatarisht, nëse një kërkues do të kishte përfunduar punën e tij/saj kërkimore për katër vite, sot Kosova do të kishte 175 rezultate kërkimore. Studiuesit e kthyer do të ishin përfshirë dhe do të mund të angazhoheshin dhe të kontribuonin në institucionet e arsimit të lartë dhe institutet e tjera kërkimore.

Megjithatë, sipas një ish-anëtari të KKS-së, MASHT-i është përpjekur ta zëvendësojë skemën e bursave në bursa me shuma minimaliste për studentët e doktoratës prej rreth 2,000 EUR për bursë, që arrijnë shumën prej 50,000 EUR në vit. Mekanizmi aktual për mbështetje për zhvillim të njohurive të reja është 480,000 EUR në vit më pak se sa skema e propozuar. Për më shumë, nuk ka dëshmi për të vlerësuar ndikimin e bursave të ofruara.

Puna kërkimore ende konsiderohet si sferë marginale në Kosovë. Programi Kombëtar i Shkencës duhet të bëhet pjesë përbërëse e sistemit të arsimit të lartë dhe me rëndësi thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Megjithatë, zbatimi i pjesshëm i programit dhe mungesa e politikave ndikojnë në një punë kërkimore të pastrukturuar dhe ad-hoc tek i gjithë komuniteti shkencor në Kosovë. Në vend që MASHT-i të përpiqet ta bëjë më të lehtë për komunitetin shkencor angazhimin në punë kërkimore, mungesa e Programit Kombëtar të Shkencës krijon konfuzion tek hulumtuesit shkencor, pasi që mungon përcaktimi i fushave prioritare për kërkim dhe mundësitë e financimit.

Sa i përket monitorimit të zbatimit të dokumentit strategjik të K&I, nuk ka përpjekje të vazhdueshme për të krijuar mekanizma për zbatimin e politikave të K&I dhe për të krijuar një sistem adekuat për ta vlerësuar dhe monitoruar zbatimin e planit për zbatimin e PKS-së. Progresi drejt arritjes së objektivave dhe synimeve të PKS-së nuk u mat si duhet duke e bërë vlerësimin dhe raportimin në mënyrë jo-sistematike. Prandaj, kërkimi shkencor në Kosovë jo vetëm që ka mungesa në "fazën e zbatimit - kryesisht për shkak të mungesës së fondeve dhe rëndësisë nga Qeveria e Kosovës - por gjithashtu mbetet i pazhvilluar në fazën e vlerësimit dhe të monitorimit"<sup>42</sup>. Kjo, nga ana tjetër, ka një ndikim negativ në zhvillimin e K&I. MASHT-i duhet të paraqesë

<sup>41</sup> Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë. KEEN, 2018.

<sup>42</sup> Edukimi dhe kërkimi shkencor në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Vlerësim i përvojave të vendeve dhe performancës së tyre në programet e financuara nga BE-ja, 2019.

statistika të besueshme për ta monitoruar përparimin në këtë fushë. Për më tepër, vështirësitë kryesore në kryerjen e kërkimeve shkencore në Kosovë janë mbështetja e pamjaftueshme me mjete financiare, mungesa e burimeve njerëzore dhe bashkëpunimi i dobët kombëtar dhe ndërkombëtar midis institucioneve dhe organizatave. “Financimi i pamjaftueshëm çon në infrastrukturë të dobët, mungesë laboratorësh dhe materialeve për të bërë eksperimente dhe mungesë të stimulimit për kërkime të komercializuara <sup>43</sup>.

### 5.3. Fondet dhe shpenzimet për K&I

Sipas Raportit të fundit të përparimit të BE-së për Kosovën "Ligji për VKSh-në nuk po zbatohet për shkak të mungesës së fondeve. Shpenzimet qeveritare për kërkime shkencore arrijnë në vetëm 0.1% të PBB-së<sup>44</sup>. Megjithatë, ky buxhet i përfshin vetëm alokimet e qeverisë për Fondin Kombëtar për Shkencë. Këtu nuk është përfshirë buxheti që ndahet për institutet kërkimore dhe universitetet, të cilat gjithashtu, sipas Ligjit për VKSh, janë përkufizuar si institucione kërkimore. Kjo tregon se Kosova ende nuk ka zhvilluar një metodologji adekuate dhe gjithëpërfshirëse për financimin e K&I. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për fondet e alokuara dhe shpenzimet në arsimin e lartë (ku përfshihet K&I) dhe ato janë të shpërndara në raporte të ndryshme dhe të paraqitura për qëllime të ndryshme. Për më tepër, të dhënat për shpenzimet për K&I zakonisht përfshihen brenda zërave buxhetorë të dedikuar për arsimin e lartë në kuadër të MASHT-it dhe për universitetet publike.

Në nivelin ndërkombëtar, *Manuali i Frascatit* i OBEZH-it<sup>45</sup> shërben si standard botëror për mbledhjen dhe raportimin e statistikave të krahasueshme ndërkombëtarisht mbi burimet financiare dhe njerëzore kushtuar kërkimit dhe zhvillimit eksperimental. Manuali i Frascatit është de facto dokumenti referencë për K&Zh nëpër vende dhe në faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik, me forma të ndryshme të strukturave ekonomike dhe të sistemeve kombëtare të kërkimit dhe me një spektër të gjerë të infrastrukturave statistikore.

Lidhur me matjen e shpenzimeve për K&Zh, *Manuali i Frascatit* i ndan ato në dy kategori kryesore dhe në disa nën-kategori:

- **Shpenzimet aktuale**
  - Shpenzimet e punës për personelin e brendshëm të K&Zh (duke i përfshirë mëditjet dhe rrogat)
  - Shpenzimet e tjera aktuale (personeli i jashtëm i K&Zh, blerja e shërbimeve dhe materialeve, shpenzimet administrative)
- **Shpenzimet kapitale**
  - Toka dhe ndërtesat
  - Makineria dhe pajisjet (TI dhe transporti, makineritë dhe pajisjet e tjera, etj.)
  - Softueri kompjuterik i kapitalizuar
  - Produkte të tjera të pronësisë intelektuale

<sup>43</sup> Edukimi dhe kërkimi shkencor në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Vlerësim i përvojave të vendeve dhe performancës së tyre në programet e financuara nga BE-ja, 2019.

<sup>44</sup> Raporti i përparimit të KE-së për vitin 2019.

<sup>45</sup> Manuali i Frascatit 2015 - Udhëzime për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave mbi kërkimin dhe zhvillimin eksperimental

Kur krahasohen këto kategori me kategoritë dhe nënkategoritë e buxhetit të Kosovës, mund të shihen ngjashmëri, si në tabelën e mëposhtme:

Kategoritë sipas manualit FRASCATI		Kategoritë e buxhetit të Kosovës
Shpenzimet aktuale	Shpenzimet e punës për personelin e brendshëm të K&Zh	Mëditjet dhe rrogat
	Shpenzimet e tjera aktuale: -Personeli i jashtëm i K&Zh -Blerja e shërbimeve, furnizimeve dhe materialeve për t'i mbështetur realizuesit e K&Zh -Të tjera (p.sh. shpenzimet e përgjithshme të administratës, shërbimet komunale)	Mallrat dhe shërbimet Subvencionet dhe transferet Shërbimet komunale
Shpenzimet kapitale	Toka dhe ndërtesat Makineria dhe pajisjet	Shpenzimet kapitale

Tabela 9. Kategoritë e shpenzimeve buxhetore sipas Frascatit kundrejt atyre të buxhetit të Kosovës

Sa i përket burimit të financimit për K&Zh (tani K&I), manuali i Frascatit i përcakton burimet e mëposhtme si burimet kryesore të financimit: ndërmarrjet e biznesit, qeveria, arsimiti i lartë, organizatat jofitimprurëse private dhe pjesa tjetër e botës (e cila i përfshin organizatat ndërkombëtare)

Prandaj, për shkak të mungesës së të dhënave për shpenzimet për K&I nga të gjitha burimet (siç janë sektori publik, sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare), është e pamundur të llogaritet indeksi i "shpenzimeve bruto të vendit për K&Zh (GERD)", i cili i përfshin shpenzimet për kërkime dhe zhvillim nga ndërmarrjet e biznesit, institucionet e arsimit të lartë, si dhe qeveria dhe organizatat jofitimprurëse private.<sup>46</sup>

Prandaj, për qëllimin e kësaj analize, është bërë një llogaritje e fondeve publike të dedikuara për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore në bazë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për periudhën 2014-2019.

Meqenëse kemi gjetur disa ngjashmëri (shih tabelën 9) midis udhëzimeve të Frascatit dhe kategorive të buxhetit të Kosovës (zërat buxhetorë), janë grumbulluar dhe analizuar të dhënat për buxhetin e planifikuar vjetor të institucioneve kryesore të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore (shih Shtojcën 4 për më shumë detaje). Buxheti vjetor i institucioneve publike është i përbërë nga disa kategori, si mëditje dhe rroga, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transferime, si dhe shpenzime kapitale. Është e qartë se buxheti i alokuar (sipas kategorive të lartpërmendura) nuk shpenzohet vetëm për veprimtarinë e K&I, por edhe për aktivitete të tjera mbështetëse, megjithatë, tabela e mëposhtme ofron ***një pasqyrë të përgjithshme të buxhetit të alokuar nga QK-ja për FKSh-në, universitetet dhe institucionet kërkimore***. Përveç kësaj, të dhënat për buxhetin e përgjithshëm vjetor të Kosovës dhe PBB-në janë paraqitur për t'u përdorur më vonë si masa për krahasim:

<sup>46</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Gross\\_domestic\\_expenditure\\_on\\_R\\_%26\\_D\\_\(GERD\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Gross_domestic_expenditure_on_R_%26_D_(GERD))

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
PBB-ja në euro	5,567,494,000	5,807,009,000	6,070,113,000	6,413,861,000	6,725,913,000 <sup>47</sup>	7,127,000,000 <sup>*48</sup>
BUXHETI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS	1,589,324,952	1 634 886 850	1,678,709,487	2,001,020,477	2,080,480,837	2,378,231,797
BUXHETI I PËRGJITHSHËM për FKSh-NË, AL dhe Institucionet Kërkimore	42,795,929	44,371,963	43,216,372	45,967,234	51,681,720	58,287,345

Tabela 10. Buxheti i institucioneve K&I

\* Vlerësimi

Burimi: Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet 2014-2019 dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Përqindja e buxhetit të alokuar për FKSh-në, universitetet dhe institucionet kërkimore si përqindje e buxhetit të Kosovës dhe PBB-së, është llogaritur në bazë të të dhënave nga tabela 10 dhe është paraqitur në figurën vijuese:




Figura 2. Buxheti për FKSh-në, AL dhe për kërkim si përqindje e buxhetit vjetor dhe PBB-së.

PBB-ja për vitin 2019 është vlerësim<sup>49</sup>, kështu që buxheti për AL dhe Kërkimin (% e PBB-së) për vitin 2019 është një përqindje e vlerësuar

Siç mund të shihet, buxheti për FKSh-në, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore si përqindje e buxhetit të përgjithshëm vjetor të Kosovës ka rënë nga viti 2014 deri në vitin 2017, kryesisht për shkak se buxheti vjetor për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore nuk ishte rritur ndjeshëm, pasi që buxheti i Kosovës rritet për çdo vit. Vetëm në vitin 2018 mund të shihet një rritje e ndjeshme prej 0,18% ose rreth 6 milion euro më shumë të alokuara në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017. Në mënyrë të ngjashme, për sa i përket përqindjes së buxhetit për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore në raport me PBB-në, mund të shihet një rritje e përqindjes nga 0.72% në vitin 2017 në 0.77% në vitin 2018. Siç u përmend më lart, përqindja për vitin 2019 është një vlerësim i llogaritur.

Në vitin 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi FKSh-në dhe asaj iu nda një shumë nga buxheti që ishte përcaktuar nga FKSh-ja. Buxheti për Fondin Kombëtar për Shkencë (FKSh) ishte

<sup>47</sup> <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-gdp-by-economic-activity-and-by-expenditure-approach-2018>

<sup>48</sup> Vlerësimi nga Programi për Reforma në Ekonomi 2019-2021

<sup>49</sup> Vlerësimi nga Programi për Reformave në Ekonomi 2019-2021

ndarë në bazë të objektivave të FKSh-së. Mjetet e FKSh-së ndahen përmes dhjetë (10) skemave kryesore të financimit. Tabela e mëposhtme është përgatitur në bazë të dhënave statistikore të MASHT-it nga "Raporti për veprimtarinë e Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë në MASHT për periudhën 2011-2019". Në të janë paraqitur informatat për skemat financiare dhe buxhetin e alokuar për skema të tilla:

Alokimet e Fondit Kombëtar për Shkencë									
Skema e financimit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Publikime <sup>50</sup>	100,000 €	100,000 €	100,000 €	85,000 €	79,000 €	79,000 €	79,000 €	79,000 €	300,000 €
Projekte të vogla shkencore	233,965 €	80,000 €	81,970 €	93,524 €	150,000 €	150,000 €	150,000 €	150,000 €	117,000 €
Shkëmbime afatshkurtra	12,000 €	15,000 €	22,000 €	40,000 €	50,000 €	50,000 €	50,000 €	50,000 €	200,000 €
Bursa për doktoratë	0 €	100,000 €	95,000 €	100,000 €	40,000 €	40,000 €	40,000 €	40,000 €	200,000 €
Çmime për studiuesit	5,000 €	7,500 €	7,500 €	6,500 €	12,000 €	12,000 €	12,000 €	12,000 €	25,000 €
Pajisje laboratorike	NA	NA	NA	50,000 €	50,000 €	50,000 €	50,000 €	50,000 €	200,000 €
Skema e kuponëve (vauçerëve) të inovacionit	NA	NA	NA	NA	15,000 €	15,000 €	15,000 €	15,000 €	NA
Bursa për pas-doktoratë	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	100,000 €
Bursa për studime master	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	100,000 €
Mbështetje për aplikim në projekte ndërkombëtare	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	10,000 €
<b>Gjithsej FKSh</b>	<b>350,965 €</b>	<b>302,500 €</b>	<b>306,470 €</b>	<b>375,024 €</b>	<b>396,000 €</b>	<b>396,000 €</b>	<b>396,000 €</b>	<b>396,000 €</b>	<b>1,252,000 €</b>

Tabela 11. Fondi Kombëtar për Shkencë, alokimet buxhetore sipas skemave (2011-2018)

Burimi: MASHT- Raport për veprimtarinë e Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë në MASHT për periudhën 2011-2014

Në tabelën e mësipërme janë dhënë informata mbi fondet e planifikuara për skemat shkencore dhe kërkimore, por jo për shpenzimet reale që janë krijuar gjatë tre viteve të fundit. Aktualisht nuk ka të dhëna në dispozicion, për qëllimin e kësaj analize, në lidhje me buxhetin e shpenzuar në fushën e AL dhe K&I.

Në praktikë, fondet e alokuara për K&I duket se janë më të ulëta në krahasim me ato të planifikuara. Ky fakt është theksuar edhe në raportin “Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë”, ku thuhet se “Në vend të shumës prej 5,393,953 EUR të planifikuar për financimin e aktiviteteve që lidhen me kërkimin, shkencën, infrastrukturën, mobilitetin dhe ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor, në pesë vitet e fundit vetëm 520,000 EUR në vit janë ndarë nga MASHT-i. Vetëm vlerësimi aritmetik i problemit nënkupton që skema e re e shpenzimeve të fondit të shkencës është 4,873,953 EUR më pak se sa që parashihej me PKSH për të mbështetur shkencën dhe komunitetin

<sup>50</sup> Publikime akademike dhe shkencore

shkencor në Kosovë. Për shembull, kur është planifikuar krijimi i 10 laboratorëve, secili prej tyre është vlerësuar të kushtojë më shumë se 250,000 EUR, ndërsa buxheti i përgjithshëm i fondit për shkencë prej 520,000 EUR është i mjaftueshëm për të themeluar vetëm dy laboratorë, duke lënë anash të gjitha aktivitetet e tjera"<sup>51</sup>.

Sipas përfaqësuesve të MASHT-it, edhe pse buxheti është shumë i ulët, zakonisht ai nuk shpërndahet plotësisht, për shkak të numrit të vogël të aplikimeve për financim të projekteve që i pranon ministria. Studiuesit nuk aplikojnë pasi që madhësia e granteve në dispozicion nuk është e mjaftueshme që ata të kryejnë një aktivitet të rëndësishëm kërkimor.

Në vitin 2015, MASHT-i ka bërë një vlerësim të PSAK-ut të mëparshëm (2011-2016). Në të janë dhënë informata në lidhje me shpenzimet për AL dhe proporcionin në raport me PBB-në dhe buxhetin e përgjithshëm të Kosovës (BPK). Tabela më poshtë është përgatitur në bazë të Raportit të vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2014.

	2011	2012	2013	2014
Financimi i arsimit të lartë (miliona euro)	34.63	37.62	41.02	50.76
Shpenzimet në AL si% e PBB-së	0.77%	0.77%	0.77%	0.77%
Shpenzimet në AL si% e BK-së	2.45%	2,61%	2.79%	3,19%

Tabela 12. Shpenzimet në arsimin e lartë

Burimi: Raporti Vjetor i Vlerësimit për vitin 2018 për Zbatimin e Planit të Veprimit të PSAK-ut.

## 5.4. Kapacitetet kërkimore dhe publikimet

Në Kosovë, kapacitetet kërkimore janë adresuar vazhdimisht (Raportet e përparimit të KE-së gjatë dekadës së fundit) si një fushë që duhet të përmirësohet në mënyrë sistematike. Kapacitetet kërkimore përfshijnë kryesisht studiues të përgatitur, me njohuri dhe aftësi të konsiderueshme për të arritur përsosmëri në kërkim, duke përfshirë ndërmarrjen, aplikimin dhe shpërndarjen e punës kërkimore (OBEZH, pa datë)<sup>52</sup>. Kjo kryesisht mbështetet tek studiuesit e përgatitur me kualifikim përkatës akademik. Megjithatë, në Kosovë nuk ka një kuptim të përbashkët për profilin e studiuesve. Studiuesit që punojnë në universitete përkufizohen me Ligjin për Arsimin e Lartë:

<sup>51</sup> Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë. KEEN, 2018.

<sup>52</sup> [https://www.oecd.org/sti/Session%204\\_The%20evolving%20path.pdf](https://www.oecd.org/sti/Session%204_The%20evolving%20path.pdf)

<sup>53</sup> Ligji për Arsimin e Lartë udhëzon se në Universitet dhe në statutet e IAL-ve të tjera mund të specifikohen kritere më specifike për secilin titull akademik. Dallimi midis titujve akademikë që kërkojnë doktoraturë kryesisht ka të bëjë me numrin e publikimeve në revista me recensim ndërkombëtar, si dhe me periudhën e caktuar të përvojës në mësimdhënie dhe zhvillim akademik/të kurrikulave.

Titulli akademik	Përshkrimi i kualifikimit dhe i përvojës <sup>53</sup>
<b>Titujt akademikë në universitete</b>	
<b>Profesor i rregullt</b>	Doktorata e përfunduar Publikime në revista me recension ndërkombëtar Të paktën 8 vjet udhëheqje të suksesshme akademike përmes hartimit të kurrikulave, risive pedagogjike, kërkimit dhe publikimit
<b>Profesor i asociuar</b>	Doktorata e përfunduar Publikime në revista me recension ndërkombëtar Një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, kërkimit dhe të praktikës profesionale apo artistike
<b>Profesor asistent</b>	Doktorata e përfunduar Publikime në revista me recension ndërkombëtar Një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike
<b>Asistent universiteti</b>	Studime të përfunduara të masterit
<b>Titujt akademikë në institucionet e tjera të arsimit të lartë</b>	
<b>Profesor</b>	Doktorata e përfunduar Publikime në revista me recension ndërkombëtar Një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, kërkimit dhe të praktikës profesionale apo artistike
<b>Profesor asistent</b>	Doktorata e përfunduar Publikime në revista me recension ndërkombëtar Një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, kërkimit dhe të praktikës profesionale apo artistike
<b>Ligjërues</b>	Së paku studime të përfunduara Bachelor Një sfond të suksesshëm të mësimdhënies <sup>54</sup>
<b>Asistent ligjërues</b>	Së paku studime të përfunduara Bachelor

Tabela 13. Titujt akademikë në arsimin e lartë në Kosovë.

Burimi: Ligji për Arsimin e Lartë

Dallimi midis titujve akademikë që kërkojnë doktoraturë kryesisht ka të bëjë me numrin e publikimeve në revista të me recension ndërkombëtar, si dhe me periudhën e caktuar të përvojës në mësimdhënie dhe zhvillim akademik/të kurrikulave. Universitetet në Kosovë nuk kanë vende kërkimore të punës. Në fakt, për sa i përket dispozitave të Ligjit për AL (neni 26), vetëm nga titujt akademikë profesor i rregullt, profesor i asociuar dhe profesor asistent kërkohet të dëshmojnë përfshirje në punë hulumtuese dhe publikime. Prandaj, ata që punojnë në këto pozita në të njëjtën kohë konsiderohen edhe si studiues.

Ndërsa Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore i përkufizon titujt për shkencëtarët dhe studiuesit, të cilat janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Titulli	Përshkrimi
<b>Titujt shkencorë</b>	
<b>Bashkëpunëtor shkencor</b>	Gradën e doktorit të shkencës, që ka Së paku një punim shkencor të botuar në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare.
<b>Bashkëpunëtor i lartë shkencor</b>	Gradën e doktorit të shkencës, që ka Së paku tri punime shkencore të publikuara në revistat relevante ndërkombëtare (dy prej tyre pas zgjedhjes së fundit)
<b>Këshilltar shkencor</b>	Gradën e doktorit të shkencës, që ka Së paku pesë punime shkencore të publikuara në revistat relevante ndërkombëtare (dy prej tyre pas zgjedhjes së fundit) dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë shkencore.
<b>Titujt hulumtues</b>	
<b>Hulumtues</b>	Ka kryer studimet master për master shkencor, me notë mesatare mbi 8
<b>Hulumtues i pavarur</b>	Ka regjistruar studimet e doktoraturës dhe që ka punime të publikuara në revista shkencore

Tabela 14 Titujt shkencorë dhe hulumtues në Kosovë

Burimi: Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

<sup>54</sup> Nuk është specifikuar në mënyrë të qartë në Ligjin për AL



Vendet kërkimore-shkencore të punës në Kosovë janë të krahasueshme me titujt kërkues-shkencor që njihen në ERA. Iniciativa e BE-së për shkëmbimin e hulumtuesve - EURAXESS, përkufizon katër lloje të titujve hulumtues<sup>55</sup>:

Titulli	Përshkrimi
<b>Hulumtues i Shkallës së Parë (R1)</b>	Kandidatët për doktorë shkencash që bëjnë kërkime nën mbikëqyrje në industri, institute kërkimore ose universitete.
<b>Hulumtues i njohur (R2)</b>	Ata që kanë gradën e doktorit të shkencave, por që nuk kanë krijuar ende një nivel të konsiderueshëm të pavarësisë. Hulumtuesit me nivel ekuivalent të përvojës dhe kompetencës.
<b>Hulumtues i pavarur (R3)</b>	Hulumtuesit që kanë zhvilluar një nivel të pavarësisë.
<b>Hulumtues udhëheqës (R4)</b>	Hulumtuesit që udhëheqin fushën ose lëminë e tyre hulumtuese.

Tabela 15. Titujt/profilit hulumtues në EURAXESS  
Burimi: EURAXESS

Në fakt, të dhënat nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës tregojnë se institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë punësuar staf akademik me kualifikime si doktor shkence, kandidat për doktor shkence, master, doktor i mjekësisë, bachelor (asistentë) dhe inxhinierë (Shih figurën 4).




Figura 3. Numri i stafit akademik të punësuar në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë  
Burimi: E-akreditimi (KAA)<sup>56</sup>

Sipas burimit të njëjtë, 69% e stafit është personel me orar të plotë pune që punon në aktivitete të mësimdhënies dhe aktivitete kërkimore. Pavarësisht nga pozicioni i tyre akademik, stafi akademik gjithashtu ka të drejtë të angazhohet në veprimtari kërkimore dhe publikime kërkimore, siç është përshkruar në tabelën nr.12 më lart. Prandaj, numri i stafit akademik siç është paraqitur në grafikun nr. 3, po ashtu mund të konsiderohet edhe si numri i hulumtuesve të punësuar në IAL-të e Kosovës,

<sup>55</sup> <https://euraxess.ec.europa.eu/europe/career-development/training-researchers/research-profiles-descriptors>

<sup>56</sup> <https://e-akreditimi.rks-gov.net> (të dhënat e marra më: 16-10-2019)

meqenëse me kushtet e kontratës ata obligohen të realizojnë projekte dhe publikime të kërkimit shkencor.

Kosova duhet t'i përkufizojë profilet kërkimore në një kuptim më të mirë dhe ekuivalent me përkufizimet ndërkombëtare. Kjo përfshin gjithashtu nevojën për punësim e hulumtuesve në universitete, me angazhim me orar të plotë për punë hulumtuese dhe projekte hulumtuese.

Për sa i përket publikimeve, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova ende renditet në fund të listës. Numri i publikimeve është i ulët, por me tendencë për t'u rritur në vitet e fundit. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur informata për periudhën 2008-2016 për numrin e artikujve në revistat shkencore dhe teknike, që i referohen numrit të artikujve shkencorë dhe inxhinierikë të publikuar në fushat e mëposhtme: fizikë, biologji, kimi, matematikë, mjekësi klinike, kërkime biomjekësore, inxhinieri dhe teknologji, dhe shkencat e tokës dhe hapësirës:




Figura 4. Artikujt në revistat shkencore dhe teknike për periudhën 2008-2016 sipas Fondacionit Kombëtar për Shkencë (indeksi FKSh)<sup>57</sup>

Burimi: Banka Botërore 2019 <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=2&series=IP.JRN.ARTC.SC&country=#>

## 5.5. Infrastrukturat kërkimore-shkencore

Infrastrukturat kërkimore-shkencore luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në përparimin e njohurive shkencore dhe teknologjike. Infrastrukturat kërkimore-shkencore janë thelbësore për të

<sup>57</sup> FKSh-ja e merr parasysh numërimin e artikujve nga një grup i revistave të përfshira nga Indeksi i Citimit Shkencor (SCI) dhe Indeksi i Citimit të Shkencave Shoqërore (SSCI). Numrat e artikujve shkencorë dhe teknikë janë nga revistat e klasifikuara nga Indeksi i Citimit Shkencor i Institutit të Informacionit Shkencor (SCI) dhe Indeksi i Citimit të Shkencave Shoqërore (SSCI). Numërimet bazohen në detyra të pjesshme; artikujt me autorë nga vende të ndryshme ndahen proporcionalisht për secilin vend.

gjitha disiplinat kërkimore dhe janë mjete më i vlefshëm për lidhjen e arsimit dhe inovacionit me kërkimin. Një K&I adekuat:

- vepron si mundësues i zhvillimit me përfitime afatgjata socio-ekonomike përmes krijimit të vendeve të punës, trajnimit dhe specializimit të burimeve njerëzore
- nxit një klimë sipërmarrëse të favorshme për investimet industriale në kërkime dhe inovacion, me një ndikim të drejtpërdrejtë në të gjithë shoqërinë
- mundëson krijimin e një mjedisi tërheqës për personelin shumë të aftë shkencor.

Infrastruktura kërkimore-shkencore i referohet një game të gjerë mjetesh, objektsh dhe burimesh të tjera që janë thelbësore për komunitetin hulumtues për të kryer kërkime me cilësi të lartë në të gjitha fushat e shkencës.

Ligji për VKSh i përkufizon infrastrukturën kërkimore-shkencore si "objektet, pajimet dhe shërbimet e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore si laboratorët, bibliotekat, teknologjinë informative, revistat shkencore, arkivat si dhe të gjitha burimet e tjera me përmbajtje shkencore". Rregullorja për "Horizon 2020" i përkufizon infrastrukturën kërkimore-shkencore si objekte, burime dhe shërbime që përdoren nga komunitetet hulumtuese për të realizuar kërkime dhe për ta nxitur inovacionin në fushat e tyre. Kur është e rëndësishme, ato mund të përdoren edhe përtej kërkimit, p.sh. për arsim ose shërbime publike. Ato përfshijnë pajisje kryesore shkencore ose grupe instrumentesh; burime të bazuara në njohuri si koleksione, arkiva ose të dhëna shkencore; infrastruktura elektronike, siç janë sistemet e të dhënave dhe informatike dhe rrjetet e komunikimit; dhe çdo infrastrukturë tjetër e një natyre unike që është thelbësore për të arritur përsosmëri në kërkime dhe inovacion. Infrastruktura e tilla mund të jenë 'të vendosur në një vend', 'virtuale' ose 'të shpërndara'<sup>58</sup>.

Infrastrukturat e kërkimit janë faktorë kryesorë që e parandalojnë zhvillimin e K&I në Kosovë, sepse infrastrukturat e kërkimit janë të dobëta dhe nuk janë të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarive të K&I. Për më tepër, infrastrukturat ekzistuese të kërkimit, në krahasim me standardet botërore për kërkime shkencore, nuk i plotësojnë kriteret e cilësisë. "Ekziston një mungesë e përgjithshme e hapësirës fizike, mjeteve, instrumenteve dhe laboratorëve, ndërsa ato ekzistueset janë shumë të vjetra për kërkime shkencore dhe akademike moderne dhe cilësore. Për shembull, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka mbi 15 laboratorë në të gjitha njësitë akademike"<sup>59</sup>.

Infrastrukturat kërkimore -shkencore në një masë të caktuar janë mbuluar në dokumentet kryesore strategjike siç janë: PSAK-u dhe PKSh. Megjithatë, Ligji për VKSh nuk adreson plotësisht rregullimin e fushës së infrastrukturës kërkimore-shkencore. PSAK-u përshkruan vizionin e infrastrukturave kërkimore-shkencore në Rezultatin 7.4 "avancimi i infrastrukturës dhe teknologjisë për mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe artistike. Për ta arritur këtë objektiv, strategjia kërkon hartimin e vlerësimit të nevojave të infrastrukturës për laboratorët dhe pajisjet e nevojshme për punë kërkimore-shkencore, dhe sigurimin e mbështetjes institucionale për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme. Nga ana tjetër, PKSh-ja i ka kushtuar një objektiv përmirësimit të infrastrukturës kërkimore-shkencore "**zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore**", i cili përqendrohet në masat e politikave në vijim:

<sup>58</sup>Rregullorja (BE) nr. 1291/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 11 dhjetorit 2013 për krijimin e "Horizon 2020" - Programit Komizë për Kërkim dhe Inovacion (2014-2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1982/2006/EC

<sup>59</sup> Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë. KEEN, 2018.

- Financim konkurrues i rrjeteve të infrastrukturës kërkimore-shkencore dhe laboratorëve qendrorë kombëtarë në fushat prioritare shkencore.
- Financimi i projekteve të pavarura për pajisje, përmes procesit të prokurimit bazuar në planet zhvillimore dhe në procedura konkurruese të tenderimi.
- Blerja ose zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi informativ të KZhT-së, i cili gjithashtu shërben edhe për sigurimin e statistikave për shkencën e teknologjinë në shkallë kombëtare.
- Sigurimi i qasjes për hulumtuesit kosovarë në bibliotekat përkatëse elektronike (p.sh. Thomson Web of Knowledge; SCOPUS etj).<sup>60</sup>

Për sa i përket buxhetit të planifikuar, rreth 21 milion euro ishin planifikuar për t'i financuar masat dhe aktivitetet e PKSh-së për veprimtarinë e K&I nga viti 2010 deri në vitin 2015. Buxheti i planifikuar për "zhvillimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore" ishte vlerësuar të jetë 2.8 milion euro. PKSh-ja planifikon rreth 20 milion euro, prej vitit 2015 deri në vitin 2019<sup>61</sup>. Me të dhënat aktuale që janë në dispozicion, është shumë e vështirë të vlerësohet buxheti i alokuar për zbatimin e PKSH-së.

Përderisa, mungojnë të dhënat e monitorimit për zbatimin e PKSh-së, në dispozicion janë vetëm informacionet për vlerësimin e zbatimit të PSAK-ut, për ta rishikuar progresin në fushën e infrastrukturës kërkimore-shkencore. Raporti i fundit i vlerësimit i PSAK-ut tregon përparim të konsiderueshëm në "mbështetjen institucionale për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore"<sup>62</sup>.

Plani i implementimit të PSAK-ut paraqet treguesin e rezultateve që duhet të arrihen: hapja e laboratorëve të rinj për punën mësimore dhe kërkimore shkencore (3 laboratorë në vitin 2018 dhe 2 laboratorë në vitin 2019). Raporti i vlerësimit i vitit 2019 nuk jep asnjë tregues për arritjen e rezultatit sa i përket "mbështetjes institucionale për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore". Ai vetëm thekson se investimet në arsimin e lartë gradualisht janë rritur që nga viti 2011, dhe thotë se "gjatë vitit 2018, janë realizuar rreth 4.6 milion euro investime kapitale. Poashtu është alokuar edhe buxheti për krijimin e Hartës së infrastrukturës kërkimore-shkencore"<sup>63</sup>.

Nga ana tjetër, raportet dhe studimet në lidhje me K&I tregojnë se gjendja e infrastrukturave kërkimore-shkencore nuk po bën përparim të mjaftueshëm dhe se institucionet kërkimore sfidohen nga infrastruktura e dobët, mungesa e laboratorëve dhe materialeve për të kryer eksperimente dhe nga mungesa e stimulimit për kërkim të komercializuar. Sipas një sondazhi institucional të kryer nga Banka Botërore, "katër organizata raportuan gjithsej 27 pajisje/objekte laboratorike, 7 prej të cilave u vlerësuan se janë në gjende të keqe ose të mirë. Sa i përket objekteve laboratorike, tre nga pesë institucione mendojnë se nuk janë përmbushur standardet ndërkombëtare të sigurisë, se kushtet fizike nuk vlerësohen rregullisht, se nuk ekziston një plan investimi dhe se nuk monitorohen rezervat (stock) i objekteve laboratorike. Kosova "ka një sfidë të rëndësishme sa i përket infrastrukturës për K&Zh në institucionet kërkimore-shkencore"<sup>64</sup>.

<sup>60</sup> Programi Kombëtar i Shkencës, 2010.

<sup>61</sup> Llogaritje e bazuar në buxhetin e planifikuar të PKSh-së.

<sup>62</sup> Raporti vjetor i vlerësimit i PSAK-ut 2017-2021, 2019.

<sup>63</sup> Raporti vjetor i vlerësimit i PSAK-ut 2017-202, 2019.

<sup>64</sup> Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion; Seria e dokumenteve të vendit- Kosova, Projekti i Asistencës Teknike të Bankës Botërore, 2013.

MASHT-i dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në fushën e K&I, nuk kanë regjistër adekuat të infrastrukturave të kërkimit. Ligji për VKSh përcakton se institucionet shkencore duhet të regjistrohen dhe licencohen nga Ministria përkatëse për shkencë (MASHT-i). Për ta kryer regjistrimin dhe licencimin, MASHT ishte i obliguar me Ligjin për VKSh që të hartojë akte nënligjore që i rregullojnë procedurat e regjistrimit dhe të licencimit të institucionit shkencor. MASHT-i nuk ka përgatitur procedura të tilla dhe procesi i regjistrimit dhe licencimit nuk është iniciuar ende<sup>65</sup>. Rrjedhimisht, kjo rezulton që të mos ketë informacione për numrin e institucioneve kërkimore-shkencore, numrin e studiuesve, infrastrukturën ekzistuese, kërkimet e paraqitura, etj.

Për më tepër, informacioni mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, si p.sh. numri i publikimeve, mundësitë për financim të kërkimeve shkencore, nuk është grumbulluar, por është i shpërndarë në raporte të ndryshme ose në burime në internet. Raportimi është bërë pjesë e rregullt e shkencës në çdo nivel. Nga studiuesit dhe institucionet kërkimore-shkencore kërkohet të raportojnë tek organizatat dhe sponsorët e jashtëm financues/e. Llogaridhënia publike, veçanërisht në aspekt të financimit, me kalimin e kohës gjithashtu po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Në të njëjtën kohë, universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore ende përballen me probleme të mëdha kur bëhet fjalë për ofrimin e informacionit mbi performancën e kërkimit shkencor. Shkaqet e këtyre problemeve janë shpesh shumë të ngjashme në secilin institucion - ruajtja e shpërndarë e të dhënave pa asnjë interfejs, sisteme të menaxhimit që nuk arrijnë t'i hartëzojnë kontekstet e kërkimit shkencor, dhe përdorueshmëria e kufizuar e sistemeve ekzistuese. Në mungesë të një baze të dhënash që do t'i mbledhë dhe do të ruajë të gjitha studimet kërkimore-shkencore në Kosovë, nuk ka të dhëna të mjaftueshme ose të qëndrueshme për ta përcaktuar gjendjen aktuale të kërkimit-shkencor në Kosovë. Sa i përket thirrjeve të hapura ndërkombëtare për grante, ato zakonisht postohen në internet në ueb-faqet e tyre, e disa prej tyre edhe në ueb-faqen e MASHT-it. Prandaj, nuk ekziston një sistem i integruar informacioni i kërkimit-shkencor, edhe pse, një sistem i tillë ishte planifikuar të krijohej sipas objektivit 2 "Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore" të PKSH-së, në aktivitetin 2.3 të këtij objektiv thuhet se "Blerja ose zhvillimi

dhe zbatimi i një sistemi informativ të KZhT, i cili, gjithashtu, u shërben kërkesave të statistikave kombëtare të Sh&T<sup>66</sup>"

Për më tepër, të dhënat për infrastrukturën ekzistuese kombëtare të kërkimit-shkencor dhe nevojat e institucioneve kërkimore-shkencore, veçanërisht sa i përket mungesës së pajisjeve shkencore, përmirësimit dhe krijimit të infrastrukturave të reja kërkimore-shkencore, nuk janë mbledhur dhe janë të panjohura. Nuk ka analiza të përgjithshme ose hartëzime të infrastrukturave kombëtare të kërkimit-shkencor dhe të kapacitetit ekzistues të pajisjeve kërkimore-shkencore.

Në nivelin strategjik, kjo analizë mund të konsiderohet edhe si pikënisje drejt hartimit të një Udhërrëfyese Kombëtar për infrastrukturën kërkimore-shkencore, që do të mundësojë:

- Identifikimin e ekzistimit të K&I aktuale
- Identifikimin e drejtimeve strategjike për zhvillimin e infrastrukturës në nivel kombëtar
- Përdorimin e fondeve dhe programeve që janë në dispozicion të cilat synojnë përmirësimin dhe ndërtimin e K&I
- Koordinimin e fondeve investuese për infrastrukturën e kërkimit shkencor, etj.

<sup>65</sup> Intervistë me stafin e Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë.

<sup>66</sup> Programi Kombëtar për Shkencë i Republikës së Kosovës (2010).

---

Udhërrëfytyesi i infrastrukturave kërkimore-shkencore do të duhet të jetë në përputhje me prioritetet e përcaktuara në politikat e K&I, siç janë PKSh-ja, Strategjia për inovacion dhe ndërmarrësi, Strategjia për Specializim të mençur (e cila është në fazën fillestare), si dhe dokumentet e tjera strategjike.

Kryesisht institucionet e arsimit të lartë janë përfitues të programeve evropiane të arsimit në të gjitha sferat e zhvillimit të tyre, të tilla si zhvillimi i gradave të studimit, përmirësimi i qeverisjes dhe i strukturave universitare, zhvillimi i sigurimit të cilësisë, zhvillimi i kërkimit dhe inovacionit, bashkëpunimi i universiteteve me industrinë dhe veprime të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e universitetit.

Si konkluzion i përgjithshëm në lidhje me zbatimin e politikave të K&I, është se, përkundër objektivave dhe masave të planifikuara në PKSh dhe PSAK dhe fondeve të alokuara, hapësira e K&I në Kosovë është ende e pazhvilluar dhe siç thuhet në Raportin e përparimit të KE-së për vitin 2019, konsiderohet se ajo "është në fazë të hershme të përgatitjes për shkencë dhe kërkim<sup>67</sup>".

---

<sup>67</sup> Raporti i përparimit i BE-së për Kosovën për vitin 2019

## 6. PËRVOJA E VENDEVE RAJONALE

### 6.1. Sistemi austriak i K&I

Përkundër ndryshimeve në përbërjen e qeverisë në dhjetor të vitit 2017 (krijimi i një koalicioni midis Partisë Popullore konservatore të Austrisë dhe partisë së djathtë populiste Partia e Lirisë e Austrisë) dhe në maj të vitit 2019 (përfundimi i koalicionit dhe emërimi i një qeverie kalimtare të përbërë nga ekspertë), sistemi i përgjithshëm institucional i K&I në Austri ndryshoi vetëm pak. Ndryshimi më i dukshëm ishte se ish-Ministria Federale e Shkencës, Kërkimit dhe Ekonomisë (deri në vitin 2017) u nda dhe u ristrukturua në Ministrinë Federale të Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit (BMBWF) dhe Ministrinë Federale të Çështjeve Digjitale dhe Ekonomike (BMDW). Këto dy ministri dhe Ministria Federale për Transport, Inovacion dhe Teknologji (BMVIT) janë ministrinë kryesore që merren me çështjet e K&I në nivelin federal në Austri (shih Figurën 6).




Figura 5. Struktura qeverisëse e sistemit austriak të K&I

I ashtuquajturit “Task Force RTI”, një organ ndërministror, e koordinon dhe e mbikëqyr zbatimin e strategjisë austriake për RTI (BKA dhe të tjerët, 2011)<sup>68</sup>. Qeveria e fundit federale ia besoi “Task

<sup>68</sup> BKA, BMF, BMVIT, BMWF, BMUKK dhe BMWFJ (2011): Si të bëhesh një udhëheqës inovativ. Strategjia për kërkim, teknologji dhe inovacion e Qeverisë Federale të Austrisë. Mars 2011. <https://era.gv.at/object/document/3040>

Force RTI” zhvillimin e Strategjisë së re austriake të RTI 2030 (ende nuk është në dispozicion). Sikurse më parë, përzjerja e politikave në Austri në të ardhmen do të përbëhet nga masat poshtë-lart dhe lart-poshtë, si dhe nga masat e drejtpërdrejta dhe indirekte të financimit të kërkimit. Po kështu - siç thekson OBEZH-i (2018<sup>69</sup>) dhe Këshilli Austriak (2019<sup>70</sup>, 2017<sup>71</sup>) - Austria duhet të përpiqet për një efikasitet më të madh (në kuptimin e përmirësimit të lidhjes midis të hyrave dhe rezultatit). Në fakt, Austria sot ka kuotën e dytë më të lartë të kërkimit shkencor në Evropë, por vetëm një pozicion në mes sa i përket disa treguesve të rezultatit.

Agjensitë kryesore të financimit të K&I në Austri janë Fondi Austriak i Shkencave (FWF), Agjensia Austriake për Promovimin e Kërkimit (FFG) dhe Austria Wirtschaftsservice Gesellschaft (aws) (shih Figurën 6).

FWF është institucioni qendror i Austrisë për promovimin e kërkimit bazë. Në vitin 2018, FWF miratoi 684 projekte të reja (2017: 642) me një buxhet të përgjithshëm prej 230.8 milion eurosh (krahasuar me 217.3 milion në vitin 2017). Për shkak të rritjes së konsiderueshme të vëllimit të aplikimeve në përafërsisht 950 milion euro (2017: 879.4 milion euro), niveli i përgjithshëm i aprovimit për sa i përket buxhetit shënoi rënie shumë të vogël prej 22.4% në 22.1% (BMBWF, BMVIT dhe BMDW, 2019<sup>72</sup>). Në vitin 2018, FWF u ngarkua të hartojë Inicativën e Përsosmërisë për Austrinë (ende nuk është publikuar) në bazë të të ashtuquajturës 'ofensivë e ardhshme', e formuluar në programin qeveritar (BMBWF, BMVIT dhe BMWD, 2018<sup>73</sup>). Është zhvilluar një strategji për vitet 2019-2021 (Programi shumëvjeçar i FWF), duke u përqendruar në tre fusha: sigurimi i cilësisë, konsolidimi i portofolit të financimit dhe dialogu me shoqërinë (FWF, 2019<sup>74</sup>). FWF është gjithashtu forca shtytëse në Austri për zgjerimin e masave në fushën e etikës dhe integritetit shkencor, si dhe në fushën e Qasjes së Hapur dhe Shkencës së Hapur.

FFG është institucioni kombëtar i financimit të K&I që lidhen me biznesin në Austri. Është në pronësi të përbashkët të BMVIT dhe BMDW. Në vitin 2018, subvencionet e garantuara me kontratë (duke i përfshirë garancitë dhe kreditë) arritën në 617.6 milion euro, që korrespondon me vlerën aktuale prej 500.8 milion euro. Përveç mbështetjes financiare, FFG gjithashtu ofron shërbime dhe konsulencë. Për shembull, FFG vepron si Pikë Kombëtare e Kontaktit për Programet Kornizë Evropiane për KTZh në Austri. Në vitin 2018, u krijua një agjenci e digjitalizimit (DIA), si një njësi e veçantë brenda FFG me qëllim të zhvillimit të Austrisë si një vend i përsosmërisë dhe inovacionit digjital.

“aws” është banka e zhvillimit të qeverisë federale. Duke ofruar kredi me kamatë të ulët, grante dhe garanci me interes të ulët, kompanitë mbështeten në zbatimin e projekteve inovative, veçanërisht nëse financimi i nevojshëm nuk mund të sigurohet në mënyrë adekuate nga burime të tjera (p.sh. përmes kredive nga banka amë). Përveç kësaj, ofrohen shërbime këshilluese dhe informacione për kompanitë që aspirojnë të krijohen (para fillimit), kompanitë fillestare (start-up),

69 OBEZH (2018): Shqyrtimet e OBEZH-it të politikës së inovacionit: Austri 2018. Vlerësim i përgjithshëm dhe rekomandime; Dhjetor 2018.

<http://www.oecd.org/publications/oecd-reviews-of-innovation-policy-austria-2018-9789264309470-en.htm>

70 Këshilli Austriak (2019): Bericht zur wissenschaftlichen und technologischen Leistungsfähigkeit Österreichs 2019.

71 Këshilli Austriak (2017): Empfehlungen für den Weg zur Innovationsspitze. 30.11.2017.

72 BMBWF, BMVIT und BMDW (2019): Österreichischer Forschungs- und Technologiebericht 2019.

<https://www.bmdw.gv.at/WirtschaftsstandortInnovationInternationalisierung/Innovation/InnovationsUndTechnologiepolitik/Seiten/FTB.aspx>

73 BMBWF, BMVIT, BMWD (2018): Vortrag an den Ministerrat. Zukunftsoffensive für Forschung, Technologie und Innovation. Wien, 16.8.2018.

74 FWF (2019): Mehrjahresprogramm 2019-2021. Strategische Eckpunkte und Vorhaben. März 2019.



kompanitë ekzistuese dhe ato që zgjerohen. Në vitin 2018, vëllimi i përgjithshëm i financimit arriti në 2,189.5 milion euro, që ishte 91.2% më i lartë se një vit më parë. Megjithatë, kjo rritje u shkaktua kryesisht nga programet e subvencioneve që jepen vetëm një herë (veçanërisht i ashtuquajtur "bonusi i punësimit"), të cilat u zbatuan nga qeveria para-paraardhëse dhe të cilat pastaj, në një masë të madhe u anuluan nga qeveria e mëparshme. Po ashtu pati edhe kontribute të konsiderueshme për shkak të përshtatjeve të kushteve të financimit për garancitë dhe kreditë, të cilat filluan në fillim të vitit 2017 dhe vazhduan në vitin 2018. Këto përfshijnë, për shembull, rritje të niveleve të limiteve financiare, rritje të gatishmërisë së rrezikut dhe ulje të tarifave të përpunimit dhe garantimit, si dhe standardizimin e udhëzimeve për kredi të "Programit të Rimëkëmbjes Evropiane" (ERP) në një program të ri të rritjes dhe inovacionit, duke ruajtur në të njëjtën kohë një shkallë të ulët historike të huazimit (BMBWF, BMVIT und BMDW, 2019)<sup>75</sup>). "aws" merret me projektet inovative investuese të kompanive tashmë të themeluara, si dhe ato të kompanive fillestare dhe kompanive të reja; për këto të fundit, kushtet e veçanta për kredi fillestare me një përqindje fikse të kamatës prej 0.5% vazhdojnë të vlejnjë gjatë gjithë afatit.

Sipas vlerësimit aktual global të Statistikës së Austrisë të prillit të vitit 2019, investimi në K&Zh në vitin 2019 do të jetë 12.8 miliardë euro, për 4.5% më i lartë se në vitin 2018 (12.2 miliardë euro). Përqindja e vlerësuar e K&Zh pritet të jetë 3.19% në vitin 2019, që paraqet një rritje të lehtë nga viti në vit (2018: 3.17%; 2017: 3.16%)<sup>76</sup>.

Së bashku, qeveria federale dhe shtetet federale do të financojnë një pjesë prej 33.9% të K&Zh që do të realizohen në Austri në vitin 2019 (2018: 34.2%), me një buxhet të vlerësuar prej 4.3 miliardë euro. Nga kjo shumë, 3.8 miliardë euro sigurohen nga qeveria qendrore. Kjo përfshin investime prej 138,7 milion euro të Fondacionit Kombëtar të Kërkimit, Teknologjisë dhe Zhvillimit dhe një shumë të vlerësuar prej 670.0 milion euro (vlerësim i BMF) për "shpërblimin për kërkim".

Kompanitë vendase do ta kenë financuar pothuajse gjysmën e të gjitha shpenzimeve të K&Zh në vitin 2019, me një vlerë prej 6.3 miliardë euro ose 48,96%. Përqindja e pjesëmarrjes së BES në financimin e përgjithshëm të K&Zh në Austri po rritet në mënyrë të vazhdueshme. Afërsisht 2 miliardë euro ose 15.6% e K&Zh në vitin 2019 do të financohen nga jashtë, shumica e të cilave do të financohen nga kompani të huaja për të kryer aktivitete të K&Zh në Austri. Financimi jo-fitimprurës privat mbetet marginal në Austri (jo më shumë se 1% e financimit të K&Zh).

Sipas EUROSTAT-it, K&Zh e financuar nga qeveria si % e PBB-së në vitin 2017 ishte 0.93 dhe BERD (si % e PBB-së) ishte 2.22.

Me një kuotë të K&Zh prej 3.17% në vitin 2018, Austria e ka vlerën e dytë më të lartë brenda BE-së - pas Suedisë. Po ashtu, Austria tregon vlera pozitive në parametrat kyç të përsosmërisë dhe ato të orientuar drejt cilësisë, siç është përqindja e citimit ose aplikimet për patenta ndërkombëtare. 10.75% e publikimeve shkencore të Austrisë janë në mesin e 10% të publikimeve më të cituara në të gjithë botën si % e publikimeve të përgjithshme shkencore të Austrisë (2016). Përqindja e Austrisë në nivel botëror në aplikimet për PCT (Patent Cooperation Treaty) në vitin 2017 ishte 0.73%. Prapë se prapë, këto shifra janë nën ato të shumicës së liderëve të inovacionit, siç përcaktohet nga EIS (2019).

75 BMBWF, BMVIT und BMDW (2019): Österreichischer Forschungs- und Technologiebericht 2019.

<https://www.bmdw.gv.at/WirtschaftsstandortInnovationInternationalisierung/Innovation/InnovationsUndTechnologiepolitik/Seiten/FTB.aspx>

76 Shih <https://rio.jrc.ec.europa.eu/en/stats/country-based-indicators>; qasur më 20 qershor 2019.

Austria është ndër liderët evropianë në bashkëpunimin midis shkencës dhe biznesit. Për sa i përket bashkëpunimit midis universiteteve dhe kompanive, Austria renditet e dyta midis të gjitha vendeve të BE-së - pas Finlandës. Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale (DESI), i përcaktuar nga Komisioni Evropian, tregon se Austria renditet vetëm në vendin e 13-të, gjegjësisht nga mesi ndërmjet 28 vendeve të BE-së (në vitin 2019). Indeksi DESI e konfirmon potencialin për zhvillim përmes shtrirjes së internetit dhe integritit të teknologjisë digjitale brenda kompanive dhe institucioneve austriake. Në fushën e shkathtësive digjitale dhe kapitalit njerëzor, megjithatë, Austria zë një pozitë të mirë po të krahasohet në nivel ndërkombëtar.

Sa i përket konkurrencës së Austrisë, Raporti Global i Konkurrencës (Forumi Ekonomik Botëror, 2018<sup>77</sup>) tregon se Austria e tejkalon mesataren e 28 vendeve të BE-së në të gjitha dimensionet. Austria renditet e 22-ta në këtë renditje krahasuese globale të 140 vendeve. Veçanërisht për sa i përket shkallës së pjekurisë së sistemit ekonomik, veprimtarisë inovative dhe kushteve të kornizës institucionale, Austria arrin vlera dukshëm më të mira se mesatarja e BE-së. Pjekuria teknologjike dhe trajnimi janë në një nivel shumë të lartë. Potenciali për zhvillim i Austrisë shihet në efikasitetin e tregut të punës dhe tregut të mallrave, si dhe në zhvillimin e tregut financiar.

Praktika e vlerësimit në fushën e K&I u vlerësua pozitivisht në analizën e fundit të OBEZH-it (2018<sup>78</sup>). Gjatë dy viteve të fundit, në Austri u përfunduan një numër i madh i vlerësimeve më të mëdha. Rezultatet e vlerësimeve janë marrë parasysh pjesërisht në nivel të politikave. Një tregues për zhvillimin e vazhdueshëm të kulturës së vlerësimit austriak është miratimi i Standardeve të reja austriake të vlerësimit në fushën e K&I. Këto standarde kanë për qëllim t'u ofrojnë autoriteteve të komisioneve, vlerësuesve dhe atyre që ndikohen nga vlerësimet, një kod sjelljeje dhe udhëzime se si të hartojnë, menaxhojnë dhe të kryejnë vlerësimet të mira dhe si t'i përdorin ato si duhet. Një dobësi strukturore e sistemit austriak të vlerësimit, e cila gjithashtu është potencuar në Analizën e OBEZH-it, është disponueshmëria e kufizuar, qasja dhe lidhshmëria e kufizuar e të dhënave statistikore në dhe të siguruara përmes organeve të sektorit publik. Platforma e regjistratit të kërkimeve shkencore, e krijuar në vitin 2018, është e angazhuar për ta lehtësuar qasjen në të dhënat nga regjistrat publik për kërkime shkencore. Megjithatë, kjo ende përfshin një numër sfidash, të cilat kërkojnë një zgjidhje gjithëpërfshirëse në nivelin ligjor, procedural dhe instrumental.

## 6.2. Sistemi i K&I i Malit të Zi

Në seksionin vijues janë dhënë informacione relevante mbi sistemin e K&I të Malit të Zi, si dhe për krijimin dhe efikasitetin e tij. Atëherë kur do të jetë e mundur, Kosova do të krahasohet me Malin e Zi në bazë të një numri të kriterëve të zgjedhura.

Mali i Zi është një vend i vogël me një ekonomi që varet nga turizmi, shërbimet e lidhura me të dhe përpunimi i metaleve. Mungesa e diversifikimit ekonomik dhe varësia nga financimi i jashtëm krijojnë cenueshmëri që mund të çojnë në kolaps të rëndë të prodhimit dhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

<sup>77</sup> Forumi Ekonomik Botëror (2018): Raporti Global i Konkurrencës 2018. Gjenevë. <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2018>

<sup>78</sup> OBEZH (2018): Shqyrtimet e OBEZH-it të politikës së inovacionit: Austri 2018. Vlerësim i përgjithshëm dhe rekomandime; Dhjetor 2018. <http://www.oecd.org/publications/oecd-reviews-of-innovation-policy-austria-2018-9789264309470-en.htm>

Që nga pavarësia në vitin 2006, Mali i Zi ka ndërmarrë një numër reformash që synojnë krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për kërkime shkencore dhe inovacion. Janë ndërmarrë hapa paraprakë, por thelbësorë. Këto përfshijnë krijimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë që përputhen me standardet evropiane, rritjen e bashkëpunimit rajonal në kërkimet shkencore, rritjen e mundësive për bashkëpunim midis institucioneve kërkimore dhe sektorit privat, dhe një kornizë të përmirësuar ligjore. Vendimi për t'u anëtarësuar në BE, i ndjekur nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit i ka dhënë një shtytje të mëtejshme zhvillimit të sistemit kombëtar të inovacionit dhe promovimit të K&Zh. Mali i Zi ka ndërmarrë hapa drejt integritit në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA). Qeveria hartoi Strategjinë për Veprimtari Kërkimore Shkencore (2008-2016, dhe 2017-2021), filloi modernizimin e sistemit arsimor dhe u angazhua për rritjen e shpenzimeve për K&Zh.

Korniza ligjore ndërkombëtare për K&I në Mal të Zi rregullohet nga:

- Memorandumi për pranimin në Programin Eureka (nënshkruar në vitin 2012)
- Deklarata për Miratimin e Strategjisë Rajonale të K&Zh për Inovacionin (nënshkruar në vitin 2013)
- Marrëveshja ndërkombëtare midis BE-së dhe Malit të Zi për pjesëmarrjen e Malit të Zi në "Horizon 2020" - (nënshkruar në vitin 2014)
- Programi Kornizë për bashkëpunimin e Malit të Zi me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike - IAEA (nënshkruar në vitin 2014)
- Memorandumi për pranimin në Programin COST (nënshkruar në vitin 2015)
- Memorandumi i mirëkuptimit për detektorin CMS në CERN (nënshkruar në vitin 2017).

Korniza ligjore kombëtare në Mal të Zi rregullohet nga:

- Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore
- Ligji për Veprimtarinë e Inovacionit
- Ligji për Arsimin e Lartë
- Ligji për Ratifikimin e Statutit të Qendrës Ndërkombëtare të Inxhinierisë Gjenetike dhe Bioteknologjisë, me protokolle dhe ndryshime (ICGEB)
- Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Qendrën e Kërkimit dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor - WISE
- Ligji për Patentat
- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura

Mali i Zi ka përcaktuar tre qëllime strategjike në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor: Zhvillimi i komunitetit hulumtues, Forcimi i bashkëpunimit shumëpalësh, rajonal dhe dypalësh, dhe Bashkëpunimi i komunitetit hulumtues me ekonominë. Në fushën e veprimtarisë së inovacionit.

Mali i Zi e ka miratuar Udhërrëfyesin Kombëtar për Zonën e Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) në vitin 2016, si një dokument politikash që e përcakton mënyrën e zbatimit të aktiviteteve brenda prioriteteve të identifikuara të ERA-s. Korniza strategjike për shkencë dhe inovacion në Malin e Zi përbëhet nga një numër dokumentesh strategjike

- Strategjia e Veprimtarisë së Inovacionit (2016-2020) me Planin e Veprimit (2016)
- Strategjia e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore (2017-2021) me Planin e Veprimit (2017)
- Udhërrëfyesi Kombëtar për Zonën e Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) (2016)
- Udhërrëfyesi për Infrastrukturat Kërkimore-Shkencore i Malit të Zi (2014-2020) (2015)

- Studimi i Fizibilitetit për Themelimin e Qendrave të Përsosmërisë në Malin e Zi (2011)
- Studimi i Fizibilitetit për Krijimin e Parkut të Shkencës dhe Teknologjisë (2011)
- Plani Strategjik për Zhvillimin e Parkut të Shkencës dhe Teknologjisë në Mal të Zi (2012)
- Strategjia për Specializim të Mençur 2019-2024
- Udhëzimet e zhvillimit të Malit të Zi (2015–2018)
- Programi i Reformave Ekonomike (PER) 2017-2019
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm të Malit të Zi deri në vitin 2030 (NSSD)
- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit të Lartë (2016-2020)
- Strategjia për Zhvillimin e NVM-ve 2018-2022 - në përgatitje e sipër
- Strategjia për Mësimin Sipërmarrës Gjatë Gjithë Jetës 2015-2019
- Strategjia për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Mal të Zi deri në vitin 2020
- Politika Industriale e Malit të Zi deri në vitin 2020
- Programi i pranimit të Malit të Zi në BE 2014-2018 (PPCG), Kapitulli 25 - Shkenca dhe Kërkimet shkencore.

Në bazë të studimit të fundit statistikor në Mal të Zi për vitin 2015, i cili ishte i koordinuar nga Ministria e Shkencës, shpenzimet totale të vendit, gjegjësisht shpenzimet bruto të vendit për kërkime shkencore dhe zhvillim (GERD) arritën në 0,38% të PBB-së. Shpenzimet e përgjithshme të vendit për K&Zh për vitin 2015 (GERD) ishin 0.38% e PBB-së, gjegjësisht shpenzimet bruto për K&Zh arritën në 13.67 milion euro.<sup>79</sup> Rezultatet kryesore të studimit kanë treguar se: në vitin 2015 kishte 2.356 persona të angazhuar në vende pune të kërkimit shkencor dhe zhvillimit në organizata, institucione dhe ndërmarrje aktive në këtë fushë, nga të cilët 1.766 studiues, 386 bashkëpunëtorë ekspertë dhe teknikë dhe 204 punonjës ndihmës.

Sa i përket Bashkimit Evropian, si nënshkrues i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Malit të Zi i është mundësuar të marrë pjesë në programet më të rëndësishme të kërkimit shkencor dhe inovacionit (K&I) të Bashkimit Evropian. Qasja në “Horizon 2020” - Programin Kornizë për Kërkime Shkencore dhe Inovacion 2014 -2020 (H2020), për të cilin marrëveshja ndërkombëtare u nënshkrua në vitin 2014, është me rëndësi të veçantë. Fonde të konsiderueshme për kontribut janë investuar në këtë program deri më tani dhe po bëhen përpjekje maksimale për të bërë një tërheqje serioze të granteve të synuara nga fondi i saj që ka afërsisht 75 miliardë euro. Në tabelën më poshtë janë dhënë informata për pjesëmarrjen e Malit të Zi në programe ndërkombëtare deri në vitin 2017:

Programi	Periudha	Numri i projekteve
<b>FP7</b>	2008-2013	<b>34</b>
<b>IAEA</b>	2007-2017	<b>14</b>
<b>COST</b>	2011-2017	<b>59</b>
<b>EUREKA</b>	2012-2016	<b>5</b>
<b>HORIZON</b>	2014-2017	<b>9</b>

*Tabela 16. Pjesëmarrja e Malit të Zi në programet ndërkombëtare*

<sup>79</sup> Strategjia e Malit të Zi për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (2017-2021)

Përveç kësaj, Mali i Zi ka marrë pjesë aktive në programe të tjera me rëndësi prioritare, si vijon: Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST), Rrjeti Pan-Evropian për K&Zh me orientim drejt tregut, industrial (EUREKA) dhe Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA). Gjithashtu, ajo është anëtarësuar në programe kërkimore me rëndësi të veçantë për shkëmbimin e studiuesve në nivel evropian: Programi Erasmus +, CEEPUS dhe Veprimi Marie Skłodowska-Curie (nën-programi H2020); e po ashtu ishte anëtare e Euraxess.

Në Mal të Zi, 80 përqind e publikimeve janë prodhuar nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat gjithashtu kanë një përqindje jashtëzakonisht të lartë të citimeve (pothuajse 95 përqind). Ky model është më ekstrem sesa në vendet e tjera të rajonit dhe se mesatarja e 27 vendeve të BE-së. Një institucion i vetëm është përgjegjës për shumicën e publikimeve në vend: Universiteti i Malit të Zi, me 634 dokumente në këtë periudhë, është i vetmi institucion me një prodhim më të madh se 16 publikime. Mali i Zi ka nivelin më të lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar në publikimet brenda vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mesatarja e bashkëpunimeve nga viti 2006 deri në vitin 2010 është 73.10 përqind, shumë mbi mesataret e 27 vendeve të BE-se dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjysma e bashkëpunimeve janë me Serbinë, dhe më pak se 5 përqind janë me Kroacinë. Vendi ka shkallë të lartë të bashkëpunimeve midis institucioneve private dhe arsimit të lartë; megjithatë, nuk ka bashkëpunim midis institucioneve private dhe atyre qeveritare<sup>80</sup>.

Një nga hapat kryesorë që janë ndërmarrë për forcimin e kërkimeve dhe lidhjeve ndërsektoriale, dhe për përmirësimin e transferimit të dijes ndërmjet organizatave që kryejnë kërkime shkencore dhe industrisë, është krijimi i Qendrës së parë të Përsosmërisë (QP) në Bio-informatikë (BIO-ICT) në Mal të Zi, e cila i mbledhi 4 institucionet kryesore kërkimore nga Mali i Zi, NVM-të dhe 2 institucione kërkimore nga jashtë. BIO-TCT është i financuar nga MSh-ja përmes HERIC, si një projekt tre-vjeçar. E njëjta praktikë është zbatuar në themelimin e Parkut Shkencor dhe Teknologjik në Podgoricë dhe të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë "Tehnopolis" në Nikshiq.

Ministria e Shkencës e krijoi Qendrën e përbashkët virtuale për shpërndarjen e burimeve: "Rrjeti i kërkimeve shkencore". Udhërrëfytyesi për Infrastrukturat Kërkimore-Shkencore i Malit të Zi (2015-2020) i njohu fragmentimin, transparencën e dobët dhe përdorimin joadekuat të infrastrukturës kërkimore si probleme kryesore. Deri në vitin 2019, u arritën rezultate të shkëlqyera në kontekstin e dukshmërisë së infrastrukturës ekzistuese kërkimore, dhe platforma onlajn "Rrjeti i kërkimeve shkencore" u krijua për studiuesit dhe institucionet e licencuara shkencore-kërkimore dhe organizatat inovative.

Për sa i përket licencimit të organizatave K&I, aktualisht, ekzistojnë 46 institucione në Regjistrin e institucioneve të licencuara për kërkim shkencor: 25 fakultete, 3 institute, 6 subjekte afariste, 1 agjenci, 4 zyra, 4 institucione të tjera publike dhe 3 OJQ.

Mali i Zi ka realizuar dy studime (në vitin 2013 dhe 2019) për kapacitetet dhe aftësitë ekzistuese të kërkimit shkencor për krijimin e një zone të përbashkët kërkimore, për ta hartëzuar infrastrukturën ekzistuese dhe kërkesat e komunitetit kërkimor malazez<sup>81</sup>. Është identifikuar dhe është regjistruar gjendja e pajisjeve ekzistuese për kërkim shkencor në Mal të Zi.

<sup>80</sup> Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion; Seria e dokumenteve të vendit- Mali i Zi, Projekti i Asistencës Teknike të Bankës Botërore, 2013.

<sup>81</sup> Studim për pajisjet për kërkim shkencor dhe për krijimin e Objektivit të Përbashkët Kërkimor, HERIC, 2019

Një krahasim i sistemit të K&I të Kosovës dhe të Malit të Zi në bazë të disa kriterëve është paraqitur në tabelën vijuese. Teksti i shënuar me shkronja të kuqe tregon elemente të sistemit K&I në Kosovë që mungojnë/nuk janë krijuar akoma ose nuk janë funksionale

Kriteri	Mali i Zi	Kosova
<b>Institucionet kryesore përgjegjëse për shkencë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ministria e Shkencës <i>Departamenti për veprimtari kërkimore-shkencore</i> <i>Departamenti për inovacion dhe zhvillim teknologjik</i></li> <li>▪ Ministria e Arsimit</li> <li>▪ Departamenti i AL</li> <li>▪ Këshilli për veprimtari kërkimore-shkencore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë <i>Departamenti për Arsim të Lartë, Shkencë dhe Teknologji</i></li> <li>▪ <b>Këshilli Kombëtar i Shkencës (jo funksional)</b></li> <li>▪ Këshilli Shkencor i MASHT-it</li> <li>▪ Këshilli Shkencor i fushave</li> </ul>
<b>Institucionet kryesore përgjegjëse për inovacion</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ministria e Shkencës <i>Departamenti për inovacion dhe zhvillim teknologjik</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë <i>Departamenti për Arsimi të Lartë, Shkencë dhe Teknologji</i></li> <li>▪ Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë <i>Departamenti për Inovacion</i></li> <li>▪ <b>Këshilli i Inovacionit Shkencor (nuk është themeluar)</b></li> </ul>
<b>Ligjet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore</li> <li>▪ Ligji për Veprimtarinë e Inovacionit</li> <li>▪ Ligji për Arsimin e Lartë</li> <li>▪ Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Qendrën e Kërkimit dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor - WISE</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore</li> <li>▪ Ligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi</li> <li>▪ Ligji për për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë</li> <li>▪ Ligji për Arsimin e Lartë</li> </ul>
<b>Korniza strategjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Strategjia e Veprimtarisë së Inovacionit (2016-2020)</li> <li>▪ Strategjia për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (2017-2021)</li> <li>▪ Udhërrëfyesi Kombëtar për Zonën e Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) (2016)</li> <li>▪ Udhërrëfyesi për Infrastrukturat Kërkimore-Shkencore të Malit të Zi (2014-2020)</li> <li>▪ Strategjia për Specializim të Mençur 2019-2024</li> <li>▪ Strategjia për Zhvillimin e Arsimit të Lartë (2016-2020)</li> <li>▪ Strategjia për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Mal të Zi deri në vitin 2020</li> <li>▪ Programi i pranimit të Malit të Zi në BE 2014-2018 (PPCG), Kapitulli 25 Shkenca dhe Kërkimet shkencore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021</li> <li>▪ <b>Programi Kombëtar i Shkencës (PKSh).</b></li> <li>▪ Strategjia Kombëtare e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (SKIN) 2019-2023</li> <li>▪ Strategjia për TI e Kosovës</li> <li>▪ Dokumentet që mungojnë:</li> <li>▪ <b>Strategjia e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore</b></li> <li>▪ <b>Udhërrëfyesi Kombëtar për Zonën e Evropiane të Kërkimit Shkencor</b></li> <li>▪ <b>Udhërrëfyesi për Infrastrukturat kërkimore-shkencore</b></li> <li>▪ <b>Strategjia për Specializim të mençur është në fazën e hershme të përgatitjes</b></li> </ul>
<b>Bartës të veprimtarisë së kërkimit dhe inovacionit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizimi i kërkimit dhe inovacionit</li> <li>▪ Qendrat e Përsosmërisë</li> <li>▪ Institucionet kërkimore-shkencore</li> <li>▪ qendrat e përsosmërisë</li> <li>▪ institucionet e arsimit të lartë</li> <li>▪ Qendrat për transferin e teknologjisë</li> <li>▪ Parqet e Shkencës dhe Teknologjisë</li> <li>▪ Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë</li> <li>▪ Inkubatorët e biznesit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizimi i kërkimit dhe inovacionit</li> <li>▪ Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës;</li> <li>▪ Universitetet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë</li> <li>▪ Institucionet kërkimore-shkencore;</li> <li>▪ <b>Qendrat e Inovacionit Shkencor;</b></li> <li>▪ Kompanitë dhe ndërmarrjet;</li> <li>▪ Institucionet e arsimit parauniversitar.</li> <li>▪ Institucionet tjera për inovacion shkencor <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <b>Institucionet zhvillimore prodhuese</b></li> </ul> </li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kompanitë</li> <li>▪ Shpikësit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Inkubatorët afarist-teknologjik</li> <li>○ Parku shkencor-teknologjik</li> <li>○ Akseleratorët (përshpejtuesit) e inovacionit shkencor</li> </ul>

<b>Organet e K&amp;I të krijuara së fundmi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani Strategjik për Zhvillimin e Parkut të Shkencës dhe Teknologjisë në Mal të Zi <i>Themelohet Parku i Shkencës dhe Teknologjisë në Podgoricë. Qeveria dhe Universiteti i Malit të Zi, janë financues. 4.3 milion euro janë investuar deri më tani</i> <i>Qendra e inovacionit dhe ndërmarrësisë "Tehopolis" Nikshiq, 2 milion euro</i> <i>Qendrat e Përsosmërisë</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka të dhëna për krijimin e organizatave të ngjashme në Kosovë</li> </ul>
<b>Regjistrimi dhe licencimi i K&amp;I</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të obliguar sipas Ligjit për VKSh</li> <li>46 K&amp;I të licencuara dhe të regjistruara</li> <li>Regjistri i Organizatave të Inovacionit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të obliguar sipas Ligjit për VKSh</li> <li>Nuk ka të dhëna për numrin e institucioneve të kërkimit</li> <li>Ende nuk është krijuar regjistër</li> </ul>
<b>Infrastruktura e K&amp;I</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Studim për pajisjet për kërkim shkencor dhe për krijimin e Objektivit të Përbashkët Kërkimor, i realizuar dy herë, në vitin 2013 dhe 2019</li> <li>Është identifikuar gjendja e infrastrukturave ekzistuese të kërkimit shkencor.</li> <li>Vlera e Infrastrukturave ekzistuese kërkimore të institucioneve kërkimore-shkencore, është rreth 28 milion euro</li> <li>Si rezultat i studimit, u miratua "Udhërrëfyesi për Infrastruktura Kërkimore të Malit të Zi 2015-2020", në përputhje me Udhërrëfyesin ESFRI</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Studime/analiza mbi Infrastrukturat kërkimore-shkencore nuk janë kryer kurrë</li> <li>Nuk ka asnjë informacion për K&amp;I-të</li> <li>Nuk ka informacion mbi vlerën e Infrastrukturave kërkimore-shkencore</li> <li>Nuk ka Udhërrëfyes për infrastrukturat kërkimore-shkencore në Kosovë</li> </ul>
<b>Financimi</b>	Në vitin 2016 arriti në 0.32% të PBB-së, GERD 0.38% (2015)	Nuk ka të dhëna të sakta, burime të ndryshme paraqesin 0.1% të PBB-së dhe GERD-it
<b>Stafi i K&amp;I</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Stafi i K&amp;I 2356 (në vitin 2018) <i>1766 studiues,</i> <i>386 teknikë dhe staf ekuivalent</i> <i>204 personel tjetër mbështetës</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e punonjësve të përfshirë në K&amp;I</li> </ul>
<b>Projektet kryesore/Donatorët kryesorë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kredi e HERIC- WB prej 12 milion eurosh <i>Gjithsej, 6 milion euro janë investuar për zhvillimin e infrastrukturave shkencore dhe kërkimore përmes projektit HERIC (Qendra e Përsosmërisë + grante).</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>HERAS</li> </ul>
<b>Pjesëmarrja në organizatat dhe programet relevante</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>ERA</li> <li>EUREKA</li> <li>COST</li> <li>CEPUS</li> <li>TEMPUS</li> <li>Programi i Shtatë Kornizë (FP7), anëtar që nga viti 2008</li> <li>"Horizon 2020", anëtar shoqërues që nga vitit 2014</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>ERA</li> <li>EUREKA</li> <li>COST (si vend i afërt fqinj)</li> <li>CEPUS</li> <li>TEMPUS</li> <li>Programi i Shtatë Kornizë (FP7)</li> <li>"Horizon 2020" (si Vend Partner i Bashkëpunimit Ndërkombëtar)</li> </ul>
<b>Statistika</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>MONSTAT prodhon statistika për K&amp;Zh <a href="https://www.monstat.org/eng/page.php?id=74&amp;pageid=74">https://www.monstat.org/eng/page.php?id=74&amp;pageid=74</a></li> <li>Statistikat e inovacionit, studimi i parë pilot i kryer në vitin 2018</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka statistikë</li> </ul>
<b>Sistemi i informacionit për K&amp;I</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrjeti i Kërkimit dhe Arsimit në Mal të Zi (MREN) <a href="http://www.mren.ac.me/">http://www.mren.ac.me/</a>. I lidhur me Rrjetin Akademik Evropian (GÉANT <a href="https://epsrc.ukri.org">https://epsrc.ukri.org</a>)</li> <li>Rrjeti i kërkimeve shkencore, <a href="https://naucnamreza.me/en">https://naucnamreza.me/en</a></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka sistem të integruar informacioni për K&amp;I</li> </ul>

Tabela 17. Krahësimi midis Malit të Zi dhe Kosovës

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1. Komete përmbyllëse

K&I në Kosovë është i pazhvilluar. Sistemi i K&I në Kosovë përballet me një sërë sfidash të rëndësishme. Efikasiteti i sistemit të K&I pengohet nga faktorë të ndryshëm, duke filluar nga mungesa e mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit; mjete të pamjaftueshme financiare kushtuar zhvillimit të K&I, burime të dobëta njerëzore që ndikon në thithjen e ulët të fondeve ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare, moskezistimi i infrastrukturës ose infrastruktura e dobët për K&I; mungesa e politikave dhe e koordinimit ndërinstytucional. Më poshtë janë dhënë disa nga përfundimet kryesore për sistemin e K&I në Kosovë:

#### **Korniza institucionale**

Aktorët kryesorë në sistemin e K&I janë MASHT-ti dhe KKSh-ja (nëse operacionalizohet). Mundësitë për ta forcuar kornizën institucionale qëndrojnë në koordinimin e mundshëm midis institucioneve kryesore të përfshira në politikën e K&I. Në fushën e inovacionit, MASHT-i dhe MIN-i i ndajnë përgjegjësitë në hartimin e politikave dhe zbatimin e politikave të inovacionit. Këto përgjegjësi të përbashkëta shpesh mund të çojnë në qarkullim të dobët të informacionit dhe në keq-komunikim.

Në aspekt të planifikimit dhe zbatimit të politikave të K&I, KKSh-ja ka një rol të rëndësishëm, megjithatë, MASHT-i nuk ka miratuar një UA të ri që do ta rregullonte procedurën për themelimin, mandatin, organizimin, zgjedhjen e anëtarëve dhe veprimtarinë e KKSh-së. KKSh-ja funksionoi deri në vitin 2011, e më pas, autoritetet relevante si Kuvendi i Kosovës dhe MASHT-i nuk arritën t'i emërojnë dhe t'i miratojnë anëtarët e KKSh-së. Duke marrë parasysh rolin kryesor të KKSh-së në zhvillimin e K&I dhe zhvillimin e politikës në nivel makro, mosfunksionimi i KKSh-së ka prodhuar pasoja negative, siç janë: prioritetet kombëtare në fushën e K&I nuk janë përditësuar dhe nuk janë identifikuar qartë; mungesa e mundësive për financim, mungesa e investimeve në infrastrukturë dhe pjesëmarrja e ulët në programe ose organizata ndërkombëtare të K&I.

#### **Politikat e K&I**

Spektori i K&I konsiderohet si një nga prioritetet kryesore politike në shumë dokumente relevante strategjike. Edhe pse është arritur përparim i konsiderueshëm në krijimin e kornizës strategjike dhe ligjore për zhvillimin e K&I, kapacitetet institucionale për zbatimin e politikave të K&I mbeten në nivele të ulëta dhe ato duhet të forcohen.

Dokumenti kryesor në fushën e kërkimit shkencor është PKSh-ja, e miratuar në vitin 2010, të cilës më pas i është zgjatur vlefshmëria me vendim zyrtar të lëshuar nga ministri i MASHT-it në vitin 2016. Vendimi do të jetë në fuqi deri sa të hartohet PKSH-ja e re. MASHT-i dhe KKSh-ja nuk kanë krijuar asnjë mekanizëm matës për ta monitoruar rregullisht zbatimin e PKSh-së, që do të përdorej si informacion gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të reja strategjike për sektorin e K&I. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur ndonjë iniciativë për të zhvilluar një orientim të ri strategjik të kërkimit shkencor në Kosovë.

Sa i përket inovacionit, QK-ja e pranon inovacionin si prioritet dhe ai fillon të konsiderohet si një element i rritjes ekonomike. Në një farë mase ekziston një kornizë e politikës për zhvillimin e



inovacionit. Zhvillimi kryesor në fushën e inovacionit është strategjia e re për inovacionin dhe ndërmarrësinë, e zhvilluar nga MIN-i. Ligji për Inovacionin Shkencor u miratua vitin e kaluar nga MASHT-i. Ai ende nuk ka shkaktuar ndonjë ndikim për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe nevojës për mekanizma të tjerë të zbatimit që duhet të krijohen, siç është Këshilli i Inovacionit Shkencor. Ligji për Inovacionin dhe Ndërmarrësinë është në proces të hartimit nga MIN-i. Megjithatë, nuk ka dëshmi se si këto dy ligje (Ligji për ISHTDT dhe Propozim-ligji për Inovacionin dhe ndërmarrësinë) do ta mbulojnë sistemin e inovacionit dhe si do t'i ndajnë përgjegjësitë e zbatimit midis aktorëve kryesorë, siç janë MASHT-i dhe MIN-i.

Në përgjithësi, ligjet dhe strategjitë e reja, në fushën e K&I, shpesh zbatohen vetëm pjesërisht për shkak të kufizimeve në buxhetet kombëtare dhe mosfunksionimit të institucioneve relevante.

### **Financimi i K&I**

Investimi në K&I është jashtëzakonisht i ulët, bile edhe po të bëhet krahasim rajonal, Kosova renditet në fund të listës së vendeve të Ballkanit Perëndimor. Investimi publik në K&I është shumë më poshtë se niveli (0.7% i buxhetit vjetor) që kërkohet nga ligji për VKSh. Mungesa e fondeve e vështirëson kryerjen e aktiviteteve të mjaftueshme për K&I, si dhe ndikon në cilësinë e aktiviteteve të K&I. Edhe pse K&I është përcaktuar si prioritet në nivelin e politikave, në nivelin e zbatimit ai nuk shoqërohet me ndarjen e fondeve të mjaftueshme për aktivitetet dhe projektet e K&I. Si rezultat i kësaj, shtrohet pyetja nëse K&I është prioritet i vërtetë për QK-në.

Çështjet e financimit nuk janë të kufizuara vetëm në nivelet e financimit, por ato kanë të bëjnë edhe me mekanizmin e financimit. Financimi publik është i centralizuar në MASHT, ndërsa institucionet kërkimore dhe studiuesit duhet të aplikojnë në MASHT për të marrë grante për ta mbështetur veprimtarinë e tyre kërkimore. Shuma e granteve që janë në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të realizuar një aktivitet cilësor të kërkimit, si dhe janë të pamjaftueshme për blerjen ose mirëmbajtjen e pajisjeve kërkimore.

Institucionet e arsimit të lartë janë realizuesit kryesorë të kërkimeve shkencore, megjithatë, rroga e stafit akademik është e dedikuar për mësimdhënie, e jo për veprimtari kërkimore-shkencore. Prandaj, nuk ka rregulla apo kërkesa të qarta kontraktuese për personelin akademik që të kryejë kërkime.

Investimi nga sektori privat në K&I është pothuajse i panjohur ose nuk ekziston fare për shkak të mungesës së informacionit se a investon sektori privat në veprimtarinë e K&I.

Aktivitetet dhe infrastruktura e K&I financohen vazhdimisht nga projektet e donatorëve dhe grantet/projektet nga organizatat ndërkombëtare.

### **Pjesëmarrja në programet kërkimore ndërkombëtare dhe rajonale**

Kosova merr pjesë në disa programe dhe iniciativa Europiane dhe rajonale për kërkime shkencore dhe inovacion. Këtu bëjnë pjesë "Horizon 2020", COST, CEEPUS dhe iniciativa të tjera. Kapacitetet kërkimore ende duhet të përmirësohen në mënyrë që institucionet kërkimore të Kosovës dhe studiuesit të jenë më konkurrues në programet kërkimore dhe publikimet ndërkombëtare. Sa i përket pikës së fundit, publikimeve të kërkimeve shkencore, sipas të dhënave të Bankës Botërore<sup>82</sup>, Kosova gradualisht, por ngadalë, po e rrit numrin e publikimeve të kërkimeve shkencore në revista me recension ndërkombëtar.

### **Infrastrukturat kërkimore-shkencore**

Infrastrukturat kërkimore-shkencore dhe kapacitetet kërkimore janë shumë të dobëta, objektet e pamjaftueshme ekzistuese shpesh janë të vjetruara dhe nuk janë të përshtatshme për qëllime kërkimore. Supozohet se ende janë larg standardeve ndërkombëtare. Prandaj, njëra nga pengesat më të mëdha për aktivitetet e K&I në Kosovë është mungesa e infrastrukturave kërkimore - shkencore në komunitetin e kërkimit për të zbatuar dhe menaxhuar projekte kërkimore-shkencore dhe mungesa e fondeve për blerjen e pajisjeve të reja dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese.

Për më tepër, infrastruktura e përgjithshme e kërkimit është e panjohur, sepse MASHT-i dhe palët e tjera të interesuara në fushën e K&I, nuk kanë regjistër adekuat të infrastrukturave ekzistuese të kërkimit siç është numri i institucioneve kërkimore-shkencore, numri i studiuësve, infrastruktura ekzistuese, kërkimet e paraqitura, etj. Përveç kësaj, informacioni mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, siç është numri i publikimeve, mundësitë për financim të kërkimeve shkencore, nuk është grumbulluar, por është i shpërndarë në raporte të ndryshme ose në burime në internet. Nuk ekziston një sistem i integruar informacioni i kërkimit-shkencor, edhe pse, një sistem i tillë ishte planifikuar të krijohej sipas objektivit 2 "Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore-shkencore" të PKSH-së<sup>83</sup>.

Të dhënat për infrastrukturat ekzistuese kombëtare të kërkimit shkencor dhe nevojat e institucioneve kërkimore nuk janë mbledhur dhe janë të panjohura. Nuk ka analiza ose hartëzime të infrastrukturave kombëtare të kërkimit shkencor dhe të kapacitetit ekzistues të pajisjeve kërkimore-shkencore. Hartëzimi i infrastrukturave të kërkimit shkencor është një instrument për identifikimin dhe kategorizimin e infrastrukturave ekzistuese dhe të planifikuara të kërkimit. Më e rëndësishme është se nuk ka strategji që i adreson në mënyrë të veçantë infrastrukturat kërkimore-shkencore në Kosovë.

### **Monitorimi dhe vlerësimi i politikave të K&I**

PKSh-ja si një dokument kryesor strategjik që synon zhvillimin e kërkimit shkencor nuk ka propozuar në mënyrë të qartë monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve, kështu që nuk ka një sistem të qëndrueshëm për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të planit për zbatimin e PKSh-së. Mosfunksionimi i KKSh-së ka ndikuar negativisht jo vetëm në zbatimin e politikave të K&I, por edhe në mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të veprimtarisë kërkimore. Progresi drejt arritjes së objektivave dhe synimeve të politikave për K&I nuk është matur si duhet duke e bërë vlerësimin dhe raportimin në mënyrë jo-sistematike.

---

<sup>82</sup> [https://data.worldbank.org/indicator/IP.JRN.ARTC.SC?most\\_recent\\_year\\_desc=false&year\\_low\\_desc=true](https://data.worldbank.org/indicator/IP.JRN.ARTC.SC?most_recent_year_desc=false&year_low_desc=true) (të dhënat e marra më: 26-09-2019)

<sup>83</sup> Programi Kombëtar për Shkencë i Republikës së Kosovës (2010)

## 7.2. Rekomandime

Rekomandimi	Aktori/ët përgjegjës	Rezultatet
<b>Mekanizmat dhe organet institucionale në K&amp;I</b>		
1. QK-ja, e në veçanti MASHT-i, duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për t'i emëruar anëtarët e KKSh-së dhe të sigurohen se ata do të miratohen nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të fillojë sërish së funksionuari institucioni më i rëndësishëm në fushën e K&I.	MASHT-i, Kuvendi	Vendimi i Qeverisë i miratuar nga Kuvendi
2. MASHT-i në fakt në të njëjtën kohë është duke zhvilluar dhe zbatuar politika të K&I, mirëpo ka mungesë të burimeve njerëzore dhe të kapaciteteve. Prandaj, MASHT-i duhet të reflektojë dhe të vendosë për ndarjen e roleve që kanë të bëjnë me zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin nga role që lidhen me zbatimin dhe ekzekutimin e politikave dhe financimit të K&I. Në këtë rast, MASHT-i dhe QK-ja duhet ta themelojnë Agjencinë për Kërkime Shkencore, siç përcaktohet në Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, si organ për ta zbatuar Programin Kombëtar të Shkencës dhe Fondin Kombëtar të Shkencës.	MASHT-i, QK-ja	Vendimi i MASHT-it/QK-së për krijimin e Agjencisë për Kërkime Shkencore, në rast se miratohet ky opcion.
<b>Përshtatja e kornizës ligjore dhe të politikave për K&amp;I</b>		
3. MASHT-i duhet të hartojë dhe të miratojë akte nënligjore që do ta rregullojnë qartë procedurën për themelimin, mandatin, organizimin, zgjedhjen e anëtarëve dhe veprimtarinë e KKSh-së.	MASHT-i, KKSh-ja	Udhëzimi Administrativ(UA) / Rregullorja
4. Meqenëse nuk është formuar PKSh-ja e re, ka nevojë urgjente për të zhvilluar një strategji të re gjithëpërfshirëse për kërkimin shkencor në përputhje me prioritetet e ERA-s dhe e cila në të ardhmen do të shërbejë si Udhërrëfyes Kombëtar drejt integritimit në ERA. Kjo strategji duhet të sigurojë lidhje të drejtpërdrejtë midis synimeve të saj dhe fondeve publike në dispozicion. Ajo po ashtu duhet të përcaktojë prioritetet të qarta të kërkimit me perspektivë afatmesme deri në atë afatgjatë.	MASHT-i/QK-ja, Kuvendi	Është zhvilluar Udhërrëfyesi për përafrimin me ERA-n PKSh-ja e re, e miratuar nga Kuvendi
5. Para hartimit të kësaj strategjie, është e detyrueshme që MASHT-i të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të ndërhyrjeve të kaluara siç është planifikuar në PKSh dhe PSAK, ndikimin e tyre, situatën aktuale, nevojat e ardhshme të institucioneve të K&I dhe prioritetet kombëtare në fushën e K&I.	MASHT-i	Raporti i vlerësimit
6. Universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë duhet t'i hartojnë planet e tyre të brendshme për kërkime shkencore dhe treguesit e zhvillimit, në përputhje me PKSh-në.	MASHT-i, Universitete t IAL	Plane të miratuara për kërkime shkencore të universiteteve
7. MASHT-i duhet të krijojë një mekanizëm adekuat të zbatimit, vlerësimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e politikave të K&I dhe për vlerësimin e ndikimit të tij.	MASHT-i	Monitorimi dhe Vlerësimi i zhvilluar (si pjesë e PKSh-se ose i veçantë)

<b>Alokimi i fondeve për kërkim shkencor</b>		
8. QK-ja duhet t'i japë prioritet të lartë K&I dhe të angazhohet për një fond më të lartë investimesh, që do të jetë më afër fondit që e alokojnë vendet e Ballkanit Perëndimor.	MASHT-i/QK-ja, Kuvendi	Korniza mesatare financiare Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (me buxhet të rritur për K&I)
9. MASHT-i dhe QK-ja duhet të parashohin një zë të veçantë buxhetor për institucionet e arsimit të lartë për t'u mundësuar atyre të investojnë në infrastrukturë kërkimore duke blerë dhe mirëmbajtur infrastrukturë kritike kërkimore.	MASHT-i/QK-ja	Buxhete të miratuara të universiteteve
10. MASHT-i dhe QK-ja duhet t'i iniciojnë ndryshimet në sistemin e financimit të K&I duke i përmirësuar mënyrat ekzistuese të financimit të projekteve dhe të zhvillojnë një model të ri të financimit. Metodat e financimit duhet të përmirësohen për ta stimuluar dhe për ta shpërblyer cilësinë e kërkimit shkencor, si dhe qeverisjen dhe menaxhimin e proceseve të lidhura.	MASHT-i/QK-ja, KPSH-ja	Legjislacioni sekondar që i përkufizon skemat dhe instrumentet financiare të FKK-së
11. QK-ja duhet të krijojë një Fond të Infrastrukturës Kërkimore-Shkencore për të siguruar fonde për inovacionin dhe për ta inkurajuar ndërmarrësinë në K&I. Pastaj, ky fond mund të sigurojë stimuj për bashkëpunim në projekte midis sektorit privat dhe komunitetit të kërkimit shkencor, në mënyrë që të krijojë produkte, shërbime dhe teknologji të reja që kanë potencial për komercializim.	MASHT-i/QK-ja, KPSH-ja	Investimi në infrastrukturën kërkimore të jetë një nga instrumentet e FKK-së.
<b>Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore</b>		
12. MASHT-i duhet ta zbatojë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kërkimit shkencor. Regjistri i organizatave të K&I do t'i sigurojë MASHT-it dhe institucioneve të tjera përkatëse informacion për numrin e institucioneve kërkimore dhe komunitetin e kërkimit shkencor.	MASHT-i	UA për licencimin e institucioneve kërkimore-shkencore i miratuar
13. MASHT-i në bashkëpunim me institucionet kërkimore duhet të kryejë një analizë të përgjithshme ose hartëzim të infrastrukturave kombëtare të kërkimit dhe të kapaciteteve ekzistuese të kërkimit shkencor.	MASHT-i	Regjistri i organizatave të K&I i miratuar, dhe një raport përmbledhës
14. MASHT-i duhet ta sponsorizojë dhe ta lehtësojë zhvillimin e Udhërrëfyesit për Infrastrukturat Kërkimore-Shkencore, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në politikat e K&I, Strategjinë për inovacionin dhe ndërmarrësinë, kërkesat e Strategjisë për specializim të mençur (në të ardhmen) si dhe me dokumentet e tjera strategjike.	MASHT-i	Dokumenti i Udhërrëfyesit
15. Duhet të krijohet një Sistem i Informacionit të Kërkimit Shkencor (RIS) i bazuar në ueb (në bazë të hartëzimit të infrastrukturave kërkimore-shkencore dhe "regjistrimit të organizatave për K&I) për të regjistruar vazhdimisht të dhëna mbi infrastrukturat kërkimore-shkencore. Infrastrukturat kërkimore-shkencore duhet të zhvillohen sipas modelit të Përbashkët Evropian të Informacionit të Kërkimit Shkencor.	MASHT-i	Infrastruktura kërkimore-shkencore është vënë në funksion dhe është operative
<b>Promovimi dhe Menaxhimi i K&amp;I</b>		
16. MASHT-i duhet ta promovojë më mirë komunitetin e kërkimit shkencor, veprimtarinë kërkimore dhe mundësitë e financimit të alokuara nga MASHT-i dhe fondet në dispozicion të programeve dhe projekteve të tjera ndërkombëtare.	MASHT-i	Një plan veprimi për promovimin e skemave dhe instrumenteve të financimit të FKSh/PKSh.
17. Themelimi i Fondit për Promovimin e Kërkimit Shkencor (me fonde publike dhe të donatorëve) për t'i mbështetur projektet kërkimore dhe zhvillimore që i synojnë studiuesit e rinj të talentuar dhe për ta forcuar lidhjen me diasporën shkencore përmes krijimit të projekteve të përbashkëta dhe formave të tjera të bashkëpunimit shkencor dhe inovacionit.	MASHT-i	Buxheti i miratuar i MASHT-it
18. Koordinimi midis MASHT-it dhe MIN-it në fushën e inovacionit duhet të përmirësohet në mënyrë që të optimizohet zbatimi i ligjeve dhe i politikave përkatëse, si dhe të nxitet bashkëpunimi ndërinstitucional në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave të inovacionit.	QK-ja/MASHT-i dhe MIN-i	Krijimi i grupit koordinues

## REFERENCAT

- Raporti vjetor i vlerësimit i PSAK-ut 2017-202, 2019.
- Praktikat më të mira të bashkëpunimit biznes-universitete-qeveri për inovacionin në Kosovë, OBEZH, 2016.
- Konkurrenca në Evropën Juglindore. Pasqyrë e politikave 2018, OBEZH, 2018.
- Raporti i përparimit i KE-së për Kosovën për vitin 2019
- Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) 2019-2021
- Edukimi dhe kërkimi shkencor në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Vlerësim i përvojave të vendeve dhe performancës së tyre në programet e financuara nga BE-ja, 2019.
- Raporti i përparimit i ERA-s për Kosovën për vitin 2018
- Raporti i përparimit i BE-së për Kosovën për vitin 2016
- Raporti i Vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, MASHT.
- Manuali i Frascatit 2015 - Udhëzime për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave mbi kërkimin dhe zhvillimin eksperimental
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021
- Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Shkencore.
- Ligji Nr. 06/L-049 për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe Teknologjisë
- Vendimi i MASHT-it numër 49/01B, i datës 10 mars 2016.
- Strategjia e Malit të Zi për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (2017-2021)
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2021 - 2016, ZKM, 2016.
- Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi, MIN.
- Shqyrtime të OBEZH-it të politikës së inovacionit: Austri 2018. Vlerësim i përgjithshëm dhe rekomandime, 2018.
- Paul Aligica. "Hartëzimi institucional dhe i palëve të interesit: Korniza për Analizën e Politikave dhe Ndryshimin Institucional," Public Organization Review, 2006.
- Rregullorja (BE) nr. 1291/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 11 dhjetorit 2013 për krijimin e "Horizon 2020" - Programit Kornizë për Kërkim dhe Inovacion (2014-2020) dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 1982/2006/EC
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Strategjia Evropa Juglindore 2020:
- Studim për pajisjet për kërkim shkencor dhe për krijimin e Objektivit të Përbashkët Kërkimor, HERIC, 2019
- Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës, 2010.
- Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë. KEEN, 2018.
- Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Kërkim dhe Zhvillim për Inovacion; Seria e dokumenteve të vendit- Kosova, Projekti i Asistencës Teknike të Bankës Botërore, 2013.
- Forumi Ekonomik Botëror (2018): Raporti Global i Konkurrencës 2018.

## UEB-FAQET:

- 1 [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research\\_and\\_innovation/era/era\\_progress\\_report\\_2018-handbook.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research_and_innovation/era/era_progress_report_2018-handbook.pdf)
- 2 <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-gdp-by-economic-activity-and-by-expenditure-approach-2018>
- 3 <http://erasmuspluskosovo.org/en/erasmus/projects/>
- 4 [http://projects.worldbank.org/search?lang=en&searchTerm=&countrycode\\_exact= XK](http://projects.worldbank.org/search?lang=en&searchTerm=&countrycode_exact= XK)
- 5 <http://www.oecd.org/publications/oecd-reviews-of-innovation-policy-austria-2018-9789264309470-en.htm>
- 6 <https://amp-mei.net/portal/>
- 7 [https://data.worldbank.org/indicator/IP.JRN.ARTC.SC?most\\_recent\\_year\\_desc=false&year\\_low\\_desc=true](https://data.worldbank.org/indicator/IP.JRN.ARTC.SC?most_recent_year_desc=false&year_low_desc=true)
- 8 <https://e-akreditimi.rks-gov.net>
- 9 [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Gross\\_domestic\\_expenditure\\_on\\_R\\_%26\\_D\\_\(GERD\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Gross_domestic_expenditure_on_R_%26_D_(GERD))
- 10 [https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research\\_and\\_innovation/era/era\\_progress\\_report\\_2018-technical.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research_and_innovation/era/era_progress_report_2018-technical.pdf)
- 11 [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150430\\_saa.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf)
- 12 <https://era.gv.at/object/document/3040>
- 13 <https://euraxess.ec.europa.eu/europe/career-development/training-researchers/research-profiles-descriptors>
- 14 <https://ickosovo.com/innovation-fund>
- 15 <https://rio.jrc.ec.europa.eu/en/stats/country-based-indicators>
- 16 <https://webgate.ec.europa.eu/dashboard/sense/app/93297a69-09fd-4ef5-889f-b83c4e21d33e/sheet/a879124b-bfc3-493f-93a9-34f0e7fba124/state/analysis>
- 17 <https://webgate.ec.europa.eu/dashboard/sense/app/e02e4fad-3333-421f-a12a-874ac2d9f0db/sheet/941d3afe-da24-4c2e-99eb-b7fcbd8529ee/state/analysis>
- 18 <https://www.bmdw.gv.at/WirtschaftsstandortInnovationInternationalisierung/Innovation/InnovationsUndTechnologienpolitik/Seiten/FTB.aspx>
- 19 <https://www.cepus.info/#nbb>
- 20 <https://www.cost.eu/>
- 21 [https://www.oecd.org/sti/Session%204\\_The%20evolving%20path.pdf](https://www.oecd.org/sti/Session%204_The%20evolving%20path.pdf)
- 22 <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2018>
- 23 <https://rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

## SHTOJCAT

### Shtojca 1: Rolet dhe përgjegjësitë në fushën e K&I

INSTITUCIONET	ROLI NË KRIJIMIN E POLITIKAVE	ROLI NË ZBATIM DHE MENAXHIM
Kuvendi Qeveria	<ul style="list-style-type: none"> <li>E miraton Programin Kombëtar të Shkencës</li> <li>Ia paraqet dhe ia propozon PKSh-në Kuvendit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E alokon buxhetin vjetor</li> </ul>
MASHT-i/ Dep. ALSHT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Propozon dhe harton politika/dokumente strategjike, legjislacion për zhvillimin e ALSHT-së</li> <li>Në bashkëpunim me Ministrinë e linjës përpilon politika dhe strategji përkatëse që e organizojnë, planifikojnë dhe e promovojnë zhvillimin e inovacionit shkencor, dhe gjithashtu bën koordinimin e palëve të interesuara.</li> <li>Ndërlidhet me sektorin ekonomik për të hulumtuar, identifikuar dhe propozuar programe studimore, kualifikime dhe kërkime shkencore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofron mbështetje në rritjen e cilësisë së infrastrukturës për zhvillimin e ALSHT-së</li> <li>Promovon zhvillimin e veprimtarisë inovative dhe kapacitetit të përgjithshëm të Kosovës në fushën e inovacionit shkencor</li> <li>Bashkëpunon me institucione dhe individë për të pasur një qasje më të organizuar ndaj veprimtarisë shkencore inovative</li> <li>Mbledh dhe siguron informacione për institucionet përgjegjëse për veprimtari shkencore inovative në vend</li> <li>I raporton qeverisë, lidhur me arritjet dhe problemet në këtë fushë</li> <li>E themelon Këshillin e Inovacionit Shkencor për ta monitoruar zhvillimin dhe zbatimin tregtar të inovacioneve shkencore</li> <li>Emëron anëtarët e KKSh-së</li> </ul>
MASHT-i/ Dep. ALSHT Divizioni për Shkencë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Propozon dhe harton dokumente të politikave dhe legjislacionin në fushën e KSh dhe TZh</li> <li>Përpunon dokumente strategjikë për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizon konkurse për financimin e projekteve shkencore dhe teknologjike</li> <li>Vendos kritere dhe metodologji për vlerësimin periodik të cilësisë dhe intensitetit të veprimtarisë kërkimore të institucioneve të financuara.</li> <li>Ofron mbështetje administrative për iniciimin dhe zbatimin e projekteve</li> <li>I shqyrton aplikimet për financim dhe e jep mendimin adekuat.</li> </ul>
MASHT-i/ Dep. ALSHT Div. ITT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Propozon dhe planifikon masa dhe aktivitete për inovacion dhe transferin e teknologjisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Propozon, harton dhe siguron zbatimin e projekteve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e ITT-së</li> <li>Ndërlidhet me sektorin ekonomik për ta lehtësuar transferimin e rezultateve të kërkimit në ekonomi dhe për t'i identifikuar nevojat e sektorit ekonomik</li> <li>E promovon kulturën e inovacionit në sektorin ekonomik</li> </ul>
MASHT-i/ Dep. ALSHT Divizioni BNALSh		<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofron mbështetje për arsimin e lartë kombëtar dhe institucionet kërkimore gjatë aplikimit për financim në programet ndërkombëtare të financimit</li> <li>Ofron këshilla për aplikimin e standardeve shkencore</li> <li>Propozon dhe harton programe për ngritjen e kapaciteteve</li> <li>Ofron mbështetje për arsimin e lartë kombëtar dhe institucionet kërkimore gjatë aplikimit për financim në programet ndërkombëtare të financimit</li> <li>Ofron këshilla për aplikimin e standardeve shkencore</li> <li>Propozon dhe harton programe për ngritjen e kapaciteteve</li> </ul>
MIN / Dep. i Inovacionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive në fushën e inovacionit</li> <li>Propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e inovacionit</li> <li>Propozon politika publike në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe iniciativave novatore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon dhe promovon projekte të përqendruara në fushën e inovacionit të të gjithë sektorëve</li> <li>Bashkëpunon me institucionet qeveritare për stimulimin dhe promovimin e prodhimeve, produksioneve dhe shërbimeve në fushën e inovacionit;</li> <li>Udhëheq dhe koordinon aktivitetet midis institucioneve publike, komunitetit të biznesit, organizatave qeveritare dhe joqeveritare që veprojnë në fushën e inovacionit në Republikën e Kosovës</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgjegjës për themelimin e Qendrave Rajonale të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;</li> <li>▪ Përgjegjës për promovimin e inovacioneve sipas sektorëve ekonomikë dhe për krijimin e mekanizmave koordinues midis shkencës, sektorit privat dhe politikëbërjes</li> <li>▪ Propozon strukturimin dhe udhëheq programet (fondet) për inovacion dhe ndërmarrësi.</li> </ul>
ASHAK	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Merr pjesë në formimin e politikave të veprimtarisë shkencore</li> <li>▪ Vlerëson situatën aktuale dhe propozon masa për avancimin e mendimit shkencor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbaton/realizon projekte shkencore</li> <li>▪ Organizon punën kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Përgatit publikim shkencor</li> </ul>
KKSh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Harton PKSh-në</li> <li>▪ Vlerëson gjendjen e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e saj, si dhe aktivitetet teknologjike</li> <li>▪ Propozon dhe stimulon marrjen e masave për përparimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Shqyrton çështje që lidhen me sistemin kombëtar të inovacioneve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Jep mendim për nevojën e themelimit, ristrukturimit ose mbylljen e institucioneve kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Vlerëson se a janë plotësuar kushtet/kriteret për krijimin e instituteve kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Ia dorëzon MASHT-it vlerësimin e kriterëve për themelimin e instituteve kërkimore-shkencore</li> </ul>
Këshilli i Inovacionit Shkencor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgatit analiza dhe plane profesionale që lidhen me veprimtarinë inovative shkencore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zgjedh praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kombëtare dhe ia propozon ato qeverisë për aplikim.</li> </ul>
Universitetet		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ushtrijnë veprimtari kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Brenda fakulteteve dhe programeve studimore, mund të themelojnë institute ose njësi të tjera për kërkim shkencor</li> </ul>
Institutet kërkimore		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ushtrijnë aktivitete kërkimore-shkencore në përputhje me prioritetet e PKSH-së</li> <li>▪ Organizojnë aktivitete në fushën e publikimeve, si dhe informojn për kërkimet shkencore</li> <li>▪ Bashkëpunojnë me institucionet e kërkimit shkencor të vendit dhe botës</li> <li>▪ Promovojnë dhe transferojnë teknologji të reja sipas arritjeve shkencore</li> <li>▪ Promovojnë integrimin e sistemit shkencor të Kosovës në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA)</li> </ul>
KSh i MASHT-it		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vlerëson zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore</li> <li>▪ Orienton zhvillimin e fushave shkencore në përputhje me PKSH-në</li> <li>▪ Ndihmon në hartimin e planit vjetor financiar të shkencës;</li> <li>▪ Propozon shpërndarjen e fondeve për veprimtarinë kërkimore-shkencore</li> </ul>
KSh të fushave		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Bëjnë vlerësimin profesional të projekteve;</li> <li>▪ Japin mendim për financimin e veprimtarive të tjera shkencore</li> </ul>
Institucionet zhvillimore prodhuese		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Krijojnë inovacion shkencor, aplikojnë teknologji të reja, bëjnë promovimin dhe vendosjen e produkteve, shërbimeve dhe teknologjive të krijuara nga puna e saj shkencore inovative dhe zhvillimore.</li> </ul>
Inkubatorët afarist-teknologjik		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vënë në dispozicion hapësirën e punës, ofrojnë shërbime administrative, teknike dhe shërbime të tjera, për ndërmarrjet ose institucionet e krijuara rishtazi që kryejnë veprimtari të inovacionit shkencor në vitin e parë të themelimit të tyre.</li> </ul>
Parku shkencor-teknologjik		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ofron shërbime profesionale dhe infrastrukurore për universitetet, institucionet kërkimore-shkencore dhe institucionet e tjera që merren me inovacion shkencor dhe që i përkasin një fushe të caktuar të shkencës.</li> </ul>



## Shtojca 2: Projektet e donatorëve

**Tabela 1: Projektet e Bankës Botërore**

Projektet	Shuma e zotimit (në miliona euro)
Ekonomia Digjitale në Kosovë (KODE)	25,00
Projekti për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit në Kosovë	11,00
Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (EPIP II)	0,00
Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim	4,50
Projekti i Arsimit dhe Shëndetit	4,44
Projekti për zhvillimin institucional të arsimit	10,00

Burimi: Banka Botërore<sup>84</sup>

**Tabela 2: Projektet e BE-së**

Projekti	Disbursimet aktuale (EUR)
IPA 2011 - Nxitja e inovacionit të rinjve në Kosovë	273,400
IPA 2010 - Përmirësimi i Kërkimeve Shkencore Shoqërore në Kosovë dhe integrimi i tyre në ERA	196,228
IPA 2009 - AT për t'i hartuar udhëzimet për aplikuesit për Zhvillimin e Kërkimeve dhe të Kapaciteteve në Kosovë IPA 2009	23,850

Burimi: Platforma për Menaxhimin e Ndihmave e Qeverisë së Kosovës<sup>85</sup>.

**Tabela 2: Projektet e ADA-s**

Projekti	Disbursimet aktuale (EUR)
Teknikat e sondazhit dhe të kërkimit shkencor për studiuesit e rinj të Universitetit të Prishtinës	9,103.61
Projekti multidimensional për Zbatimin e Partneritetit të Institucionalizuar midis Austrisë dhe Kosovës në fushën e Arsimit të Lartë, Kërkimit dhe Inovacionit	2,624,000
“Higher KOS - Promovimi i Zhvillimit Institucional në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Kosovë	1,665,508
Arsimi i lartë, Kërkimi dhe Shkencat e aplikuara (HERAS)	1,620,000
Nxitja e Inovacionit të Rinjve në Kosovë	1,164,155.45
Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në zhvillimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë kërkimore në kontekstin e përafrimit me BE-në dhe arsimin e lartë evropian	29,715
Laboratorët e inovacionit - Lidhja e rinisë me institucionet publike kosovare përmes iniciativave të sektorit privat	500,000
Mbështetje për Reformat në Arsimin e Lartë	833,300

Burimi: Platforma për Menaxhimin e Ndihmave e Qeverisë së Kosovës<sup>86</sup>

<sup>84</sup> [http://projects.worldbank.org/search?lang=en&searchTerm=&countrycode\\_exact=XX](http://projects.worldbank.org/search?lang=en&searchTerm=&countrycode_exact=XX)

<sup>85</sup> <https://amp-mei.net/portal/>

<sup>86</sup> <https://amp-mei.net/portal/>

### Shtojca 3: Prioritetet dhe treguesit e ERA-s, dhe vlerësimi i statusit fillestar të Kosovës

Prioriteti i ERA-s	Treguesi ERA-s <sup>88</sup>		Vlerësimi paraprak i statusit fillestar të Kosovës	Veprimet që duhen ndërmarrë
Prioriteti 1: Sisteme më efektive kombëtare të kërkimit shkencor	Treguesi hyrës	GBARD <sup>89</sup> si përqindje e PBB-së (Eurostat)	Me Ligjin për Kërkime Shkencore kjo përqindje është vendosur në 0.1% të buxhetit kombëtar. Megjithatë, treguesi i tillë duhet të llogaritet përsëri nga të gjitha fondet qeveritare të alokuara për K&I. Kjo duhet ta përfshijë edhe buxhetin e alokuar për arsimin e lartë.	Për llogaritjen e këtij treguesi duhet të vendoset një qasje e re e llogaritjes.
	Treguesi dalës	Treguesi i Përshtatur i Përsosmërisë së Kërkimit (REI) (Burimi: JRC)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Për të kontrolluar se si Kosova mund të gjenerojë të dhëna për llogaritjen e këtij treguesi.
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	European Innovation Scoreboard Summary Innovation Index (EIS: SII)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Për të kontrolluar se si Kosova mund të gjenerojë të dhëna për llogaritjen e EIS-it.
Nën-prioriteti 2a: Bashkëpunimi optimal transnacional	Treguesi hyrës	Pjesëmarrja në Partneritete të sektorit publik me sektorin publik (P2P) për studiues në sektorin publik (Raporti i Eurostat-it dhe ERA-Learn 2020 mbi P2P)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Llogaritja mund të bëhet duke e shikuar përfshirjen e studiuesve në bashkë-publikime.

<sup>87</sup> Marrë nga Raporti i përparimit i ERA-s për vitin 2018

([https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research\\_and\\_innovation/era/era\\_progress\\_report\\_2018-technical.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research_and_innovation/era/era_progress_report_2018-technical.pdf) : marrë më 12.09.2019)

<sup>88</sup> Matja e treguesve është shpjeguar më hollësisht në Manualin e Monitorimit të ERA-s, 2018

([https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research\\_and\\_innovation/era/era\\_progress\\_report\\_2018-handbook.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/research_and_innovation/era/era_progress_report_2018-handbook.pdf) : Marrë më: 13.09.2019)

<sup>89</sup> Alokimet për K&Zh nga buxheti i Qeverisë

	Treguesi dalës	GBARD të alokuara për programet publike transnacionale, mbarë evropiane, si dhe programet dypalëshe ose shumëpalëshe, të K&Zh për studiuës me angazhim ekuivalent me kohë të plotë (FTE) <sup>90</sup> në sektorin publik (Eurostat)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Duhet të kontrollohet financimi publik i alokuar për studiuësit ndërkombëtarë të punësuar me kohë të plotë.
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Bashkë-publikimet ndërkombëtare me partnerë të ERA-së për 1000 studiuës në sektorin publik (WoS dhe Eurostat)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Duhet të kontrollohen bashkë-publikimet e studiuësve kosovarë.
Nën-prioriteti 2b: Forumi i Strategjisë Evropiane për Infrastrukturat Kërkimore (ESFRI)	Treguesi hyrës	Përqindja e zhvillimit të projekteve të ESFRI-t në të cilat merr pjesë një vend anëtar ose një vend i asociuar.	Kjo mund të kontrollohet duke parë se nëse Kosova është pjesë e ndonjë projekti të infrastrukturës kërkimore.	
	Treguesi dalës	Disponueshmëria e udhërrëfyesve kombëtarë me projektet e identifikuar të ESFRI-t dhe nevojat përkatëse për investime (ESFRI)	Nuk ka dokument udhërrëfyes që është zhvilluar në Kosovë për infrastrukturën kërkimore.	
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Përqindja e pikave operacionale të referimit të ESFRI-t në të cilat është partner një vend anëtar ose një vend i asociuar (ESFRI).	Nuk vlen për Kosovën?	
Prioriteti 3: Tregu i hapur i punës për studiuësit	Treguesi hyrës	Përqindja e kandidatëve për doktoratë me shtetësi të një vendi tjetër anëtar i BE-së	Duhet të kontrollohet se a është në dispozicion informacioni i tillë	

<sup>90</sup> Ekuivalent me kohë të plotë

	Treguesi dalës	Postimet e studiuësve të reklamuara përmes portalit të punës të EURAXESS për 1000 studiuës në sektorin publik (EURAXESS dhe Eurostat-i)	Kosova ende nuk është anëtare e EURAXESS, dhe një informacion i tillë nuk është publikuar atje.	Vetëm Kosova nga vendet e rajonit nuk është pjesë e EURAXESS. Kjo duhet të adresohet nga MASHT-i në mënyrë që ajo të bëhet jetë pjesë e saj.
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Përqindja e studiuësve që shprehin kënaqësi që procedurat e punësimit në institucionin e tyre janë të hapura, transparente dhe të bazuara në merita (Sondazhi MORE2 dhe MORE3) <sup>91</sup>	Sondazhi MORE nuk është aplikuar ende në Kosovë.	Kosova mund të miratojë një sondazh të tillë për të gjeneruar rezultate të krahasueshme.
Prioriteti 4: Barazia gjinore dhe integrimi gjinor në kërkimet shkencore	Treguesi hyrës	Përqindja e femrave me doktoratë (Eurostat-i)	Ky informacion duhet të jetë në dispozicion, vetëm për ta llogaritur %.	Të dhënat të merren nga MASHT-/KAA.
	Treguesi dalës	Dimensioni gjinor në përmbajtjen e kërkimit (WoS)	Ky vlerësim i indikatorit mund të llogaritet nga kërkimi i mostrës proporcionale të realizuar nga studiuësit kosovarë.	
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Përqindja e grave në pozicionet e Gradës A në SAL <sup>92</sup> (baza e të dhënave të WiS - Womend in Science)	Të kontrollohet se si të llogaritet ky tregues për Kosovën, pasi pozicionet kërkimore nuk janë të përkufizuara mirë.	
Nën-prioriteti 5a: Qarkullimi i dijes	Treguesi hyrës	Përqindja e produkteve dhe/ose proceseve të firmave inovative që bashkëpunojnë me institucione të arsimit të lartë ose	Ky tregues duhet të kontrollohet si ndërqeveritar, duke përdorur baza të të dhënave nga ministri të ndryshme dhe	Të kontrollohen informatat dhe të dhënat nga: Universitetet MASHT-i

<sup>91</sup> Sondazhi evropian mbi shkëmbimin e studiuësve

<sup>92</sup> Sektori i Arsimit të Lartë

		institucione kërkimore publike/private (Eurostat-i)	agjenci të ndryshme shtetërore.	MTI Ministria e Zhv. Ek. Ministria e Inovacionit Agjencia e prokurimit ASK Burime të tjera
	Treguesi dalës	Përqindja e kërkimit shkencor publik të financuar nga sektori privat (Eurostat)	Të kontrollohet nëse të dhënat e tilla janë në dispozicion	
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Numri i bashkë-publikimeve publike-private për milion popullatë (EIS)	Asnjë llogaritje nuk është bërë në të kaluarën.	Llogaritja mund të bëhet duke e shikuar përfshirjen e studiuesve në bashkë-publikime.
Nën-prioriteti 5b: Qasja e Hapur (QA)	Treguesi hyrës	Organizatrat që financojmë kërkime shkencore (OFKSh) që sigurojnë fonde për t'i mbuluar shpenzimet e publikimit me QH dhe për qindja e publikimeve të OFKSh-ve që janë në dispozicion në QA* dhe për qindja e punimeve shkencore nga shkencat e jetës për të cilat ka kontribuar një vend dhe që kanë të paktën një dataset të hapur në Figshare*	Identifikimi i OFKSh-ve në Kosovë, dhe burimet e publikimeve të tyre të financuara.  Publikimet e identifikuar si QH	
	Treguesi dalës	Për qindja e publikimeve që janë në dispozicion në qasje të hapur (ngjyrë gjelbër dhe ari) (1 findr dhe WoS)	Llogaritja duhet të kontrollohet nga të dhënat e marra nga WoS dhe 1 findr	
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Vlerësimi cilësor i politikave për QH në Planet Kombëtare të Veprimit dhe burimet		

		e të tjera të informacionit		
Dimensioni ndërkombëtar jashtë ERA-s (Prioriteti 6)	Treguesi hyrës	Bashkë-publikimet ndërkombëtare me partnerë që nuk janë anëtarë në ERA për 1.000 studiues në sektorin publik (WoS dhe Eurostat)	Nuk vlen për Kosovën, i referohet vendeve anëtare të ERA-s	Në të kundërtën, kjo mund të llogaritet me bashkë-publikimet e studiuesve kosovarë me vendet e ERA-s
	Treguesi dalës	Studentët e doktoraturës nga vendet që nuk janë anëtarë të BE-së si përqindje e të gjithë studentëve të doktoraturës (Eurostat)	Nuk vlen për Kosovën, i referohet vendeve anëtare të ERA-s	
	Treguesi i rezultatit/ndikimit	Eksportet e produkteve të teknologjisë së mesme dhe të lartë si përqindje e eksporteve të përgjithshme të produkteve* dhe eksportet e shërbimeve me njohuri intensive si përqindje e eksporteve të përgjithshme të shërbimeve* (EIS)	Të kontrollohet nëse ka produkte teknologjike të zhvilluara në Kosovë dhe që janë eksportuar.	

#### Shtojca 4: Buxheti i institucioneve të K&I

Buxheti Vjetor (2014-2019) në EURO						
Institucionet	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (duke përfshirë FKSh)	559,937	559,937	559,937	559,937	559,937	1,848,058
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1,126,000	1,144,252	1,084,851	1,094,851	1,240,364	1,356,427
Instituti Albanologjik i Prishtinës	610,901	670,582	713,046	746,518	793,307	919,518
Instituti i Historisë	335,005	390,352	424,306	525,675	646,422	720,988
Instituti i Leposaviqit	66,012	14,092	75,019	75,300	75,300	75,300
Instituti Pedagogjik	250,239	316,089	264,489	221,359	221,359	266,359
Universiteti i Prishtinës	29,731,253	30,636,805	28,548,052	30,782,339€	33,834,712	34,785,502
Universiteti i Prizrenit	3,154,349	2,927,199	2,788,768	2,493,346	2,633,346	2,826,772
Universiteti i Pejës	2,432,230	2,793,766	2,532,956	2,376,823	3,026,823	3,628,197
Universiteti i Mitrovicës	1,510,001	2,195,005	2,602,651	2,968,698	2,905,398	4,788,969
Universiteti i Gjilanit	1,510,001	1,298,832	1,443,234	1,556,553	2,126,553	2,363,982
Universiteti i Gjakovës	1,510,001	1,425,052	1,611,793	1,615,972	2,095,972	2,460,046
Universiteti i Ferizajt	N/A	N/A	567,270	949,863	1,522,227	2,247,227
<b>Buxheti i përgjithshëm për AL dhe Institucionet Kërkimore</b>	<b>42,795,929</b>	<b>44,371,963</b>	<b>43,216,372</b>	<b>45,967,234</b>	<b>51,681,720</b>	<b>58,287,345</b>
<b>BUXHETI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS</b>	<b>1,589,324,952</b>	<b>1,634,886,850</b>	<b>1,678,709,487</b>	<b>2,001,020,477</b>	<b>2,080,480,837</b>	<b>2,378,231,797</b>
<b>PBB</b>	<b>5,567,494,000</b>	<b>5,807,009,000</b>	<b>6,070,113,000</b>	<b>6,413,861,000</b>	<b>6,725,913,000</b>	<b>7,127,000,000*</b>
BUXHETI për institucionet e AL dhe IK si % e PBB-së	0,77%	0,76%	0,71%	0,72%	0,77%	0,82%
<b>Buxheti për AL dhe K&amp;I si % e buxhetit të Kosovës</b>	<b>2,69%</b>	<b>2,71%</b>	<b>2,57%</b>	<b>2,30%</b>	<b>2,48%</b>	<b>2,45%</b>

### **Deklaratë për mohimin e përgjegjësisë:**

*Ky dokument është zhvilluar me mbështetjen e ekspertëve të HERAS në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Projekti HERAS është i mbështetur me ndihmë financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim, me fonde të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe zbatohet nga konsorciumi, Shërbimi Universitar Botëror Austri (udhëheqës i konsorciumit), Qendra për Inovacion Social (ZSI) dhe Agjencia Austriake për Shkëmbim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsim, Shkencë dhe Kërkim (OeAD). Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk e pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim e as mendimin e partnerëve implementues.*

## **Konsorciumi implementues**

